



Organizata për Siguri e Bashkëpunim në Evropë  
MISIONI NË KOSOVË

**SIGURIA DHE MBROJTJA E DËSHMITARËVE NË KOSOVË:  
VLERËSIM DHE REKOMANDIME**

**Nëntor 2007**

## TERMINOLOGJIA

GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
ShPK	Shërbimi Policor i Kosovës
OSBE	Organizata për Siguri e Bashkëpunim në Evropë
KPPK	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
KPPPK	Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës
UNHCR	Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK DD	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Departamenti i Drejtësisë
NjMD	Njësia për Mbrojtje të Dëshmitarëve

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>TERMINOLOGJIA</b> .....	<b>2</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	<b>4</b>
<b>PASQYRË E PËRGJITHSHME</b> .....	<b>5</b>
HYRJE .....	5
KORNIZA EKZISTUESE LIGJORE PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE NË KOSOVË.....	6
Dispozitat për mbrojtjen e dëshmitarëve në Kodin e përkohshëm të procedurës penale të Kosovës .....	6
Problemet në implementimin e dispozitave të Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës për mbrojtjen e dëshmitarëve.....	7
<b>KONKLuzionET NGA VLERËSIMI</b> .....	<b>8</b>
SIGURIA FIZIKE DHE ZHVENDOSJA E DËSHMITARIT .....	8
PENGESAT PRAKTIKE NË MBROJTJEN E DËSHMITARËVE.....	8
PËRMIRËSIMET E KOHËVE TË FUNDIT .....	10
<b>REKOMANDIMET</b> .....	<b>10</b>
NDRYSHIMET LEGJISLATIVE .....	10
<b>KOMENTET PËR VERSIONET A DHE B TË PROJEKT RREGULLORES PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE</b> .....	<b>11</b>
VERSIONI A:.....	11
Neni 1 .....	11
Neni 2 .....	12
Neni 3 .....	12
Neni 5 .....	14
Neni 6 .....	14
VERSIONI B:.....	14
Neni 4 .....	14
Neni 5 .....	14
Neni 7 .....	15
Neni 8 .....	15
Neni 9 .....	15
Neni 12 .....	15
Rekomandimet tjera për çështjet legjislative .....	15
NDRYSHIMET PROGRAMATIKE .....	16
a. Eksperienca dhe trajnimi.....	16
b. Siguria e objekteve të gjykatave dhe qendrave të paraburgimit.....	17
c. Çështjet e rëndësisë kritike .....	18
d. Modeli i mundshëm për NjMD-në.....	18
e. Zhvendosja jashtë vendit.....	19
<b>KONKLuzion</b> .....	<b>20</b>
<b>SHTOJCAT</b> .....	<b>21</b>

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Një sistem efektiv i drejtësisë penale që operon nën sundimin e ligjit, nuk mund të funksionojë si duhet pa prezantimin e dëshmimeve relevante në procedimet gjyqësore. Ndërsa qytetarët kanë obligim civil dhe mjaft shpesh edhe obligim ligjor për të ofruar informata lidhur me aktivitetin kriminal dëshmitar të të cilit kanë qenë, mjaft shpesh dëshmitarët hezitojnë ta bëjnë këtë, nga frika që bashkëpunimi i tyre me zyrtarët e zbatimit të ligjit kërcënon sigurinë e tyre dhe sigurinë e anëtarëve të familjes së tyre. Mbrojtja e dëshmitarëve të tillë të rrezikuar<sup>1</sup> ka qenë dhe mbetet një nga sfidat më të mëdha për autoritetet gjyqësore në Kosovë. Përkundër ekzistimit të procedurave në ligjin vendor<sup>2</sup> për mbrojtjen e dëshmitarëve (sikur që është dëshmia anonime dhe nga distanca, dëgjimet jo-publike, ndarja fizike e të pandehurit nga dëshmitari), dëshmitarët shpesh refuzojnë të paraqiten me informacione. Tepër shpesh, dëshmitarët që fillimisht japin deklaratat para policisë, më vonë ndërrojnë dëshminë e tyre apo nuk tregohen të gatshëm të dëshmojnë gjatë gjykimit, pasi që frikohen nga reprezaljet. Nuk është për t'u çuditur që incidentet e frikësimit dhe lëndimit të dëshmitarëve ngjajnë aq shpesh sa për të arsyetuar këtë ngurrim tek dëshmitarët.

Ky problem në Kosovë është dokumentuar dhe raportuar prej kohësh.<sup>3</sup> Nga fundi i vitit 2006, me kërkesë të Departamentit të Drejtësisë në UNMIK (DD), OSBE dhe Zyra e Shteteve të Bashkuara në Prishtina (USOP), përmes Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara, kanë bashkë-sponsorizuar një mision vlerësues në Kosovë, që kishte si objektiv problemin e mbrojtjes së dëshmitarëve. Ky projekt kishte marrë përsipër vlerësimin e ligjit ekzistues dhe të procedurave të tanishme për mbrojtjen e dëshmitarëve, me qëllim të hartimit të rekomandimeve gjithëpërfshirëse për përmirësimet e nevojshme. Ky raport është rezultat i atij projekti.

Në formë të përmbledhur, programi për mbrojtje të dëshmitarëve duhet të ketë financimin e mjaftueshëm për të mbështetur nivelin adekuat të stafit të specializuar të policisë, dhe për të ushtruar shumë prej funksioneve që kërkohen për një program efektiv. Një ligj më gjithëpërfshirës që do të rregullonte këtë program duhet miratuar gjithashtu. Vendimi për futjen e një dëshmitari të rrezikuar në program – që është jashtë-gjyqësor sipas natyrës – nuk duhet të jetë çështje që duhet vendosur nga gjykatat, por duhet të jetë brenda lirisë së veprimit

<sup>1</sup> Shprehja “dëshmitarët” u referohet dëshmitarëve okularë, viktimave të krimeve si dhe dëshmitarëve bashkëpunues. Të gjitha këto lloje të “dëshmitarëve” mund të ofrojnë dëshmi vendimtare në gjykim.

<sup>2</sup> Kodi i përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës ka hyrë në fuqi më 4 prill 2004.

<sup>3</sup> *Shih, psh.*, raportet e Sektorit për Monitorim të Sistemit Ligjor, të Misionit të OSBE-së në Kosovë: *Shqyrtim i Sistemit të Drejtësisë Penale në Kosovë* (2006); *Reagimi i Sistemit të Drejtësisë ndaj trazirave të marsit 2004*, 2 dhjetor 2005, faqe. 8-21; *Shqyrtim i Sistemit të Drejtësisë Penale (prill 2003-tetor 2004) Krimi, Ndalimi dhe Ndëshkimi*, 14 dhjetor 2004, faqe 74-77; *Shqyrtim i Sistemit të Drejtësisë Penale (Mars 2002 – prill 2003) Mbrojtja e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale*, 20 maj 2003.

të prokurorit publik, në konsultim me hetuesit e rastit dhe me ekspertët e Njësisë për mbrojtje të dëshmitarëve, apo nga një komision, nëse ka një të tillë. Për më tepër, duhen bërë përpjekje për ngritje të rrjeteve dhe bashkëpunimit me vendet që shfaqin gatishmërinë për pranimin dhe zhvendosjen e dëshmitarëve të mbrojtur nga Kosova. Veç kësaj, gjyqtarët duhet t'i shfrytëzojnë më mirë procedurat e mbrojtjes në ligjin ekzistues. Vetëm përmes ndërmarrjes së këtyre masave, Kosova mund të shpresojë në zvogëlimin e kërcënimeve dhe frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë, dhe të inkurajojë kështu një përfshirje dhe pjesëmarrje të shtuar të dëshmitarëve.

## PASQYRË E PËRGJITHSHME

### Hyrje

Mbrojtja e dëshmitarëve nga kërcënimet apo frikësimi ka qenë dhe mbetet një nga sfidat kryesore për autoritetet e drejtësisë në Kosovë. Përkundër kornizës ligjore dhe përdorimit të shtuar të masave për fshehjen e identitetit të, me qëllim të mbrojtjes së dëshmitarëve në procedimet gjyqësore, numri i dëshmitarëve që janë treguar të gatshëm të dëshmojnë në gjykatë ende është mjaft i kufizuar. Incidentet e frikësimit të dëshmitarëve janë regjistruar rregullisht.

Që nga viti 2003, UNMIK-u ka bërë përpjekje për adresimin e këtij problemi përmes implementimit të "Programit për mbrojtje të dëshmitarëve" në pajtim me Qarkoren e DD të UNMIK-ut 2003/5, për trajtimin e rasteve më serioze të dëshmitarëve të rrezikuar.<sup>4</sup> Megjithatë, mungesa e kornizës së hollësishme ligjore e ka bërë këtë detyrë edhe më të vështirë. Në vitin 2006, UNMIK-u ka filluar me finalizimin e Rregullores për themelimin formal të Programit për mbrojtje të dëshmitarëve.<sup>5</sup> Me kërkesë të DD të UNMIK-ut, OSBE dhe USOP janë pajtuar të kryejnë një vlerësim të praktikave dhe procedurave ekzistuese për mbrojtjen e dëshmitarëve, të identifikojnë nevojat më të ngutshme dhe të bëjnë rekomandime për implementim të përmirësimeve në kornizën ligjore, si dhe në procedurat operacionale.

USOP dhe OSBE, duke punuar ngushtë me DD të UNMIK-ut, kanë siguruar një ekip ekspertësh për të bërë vlerësimin e nevojave. Gjatë një jave në vjeshtën e vitit 2006, ekipi ishte takuar me zyrtarët e Kosovës dhe ata të UNMIK-ut që janë përgjegjës për mbrojtjen e dëshmitarëve, si dhe me zyrtarët përfaqësues të sistemit të drejtësisë penale që shpesh ndeshen me situatat ku përfshihen dëshmitarët e rrezikuar.<sup>6</sup> Synim i këtij projekti ka qenë identifikimi i hapave që duhen ndërmarrë për të përmirësuar aftësinë e Kosovës për mbrojtjen e dëshmitarëve të rrezikuar në rastet më serioze kriminale – së fundi, për të forcuar sundimin e ligjit.<sup>7</sup> Mjaft shpesh, garantimi i sigurisë së dëshmitarëve nuk

<sup>4</sup> Shih Shtojcën 1 (Qarkorja e DD të UNMIK-ut 2003/5).

<sup>5</sup> Shih Shtojcën 2 (Projekt Rregullorja për Programin e mbrojtjes së dëshmitarëve).

<sup>6</sup> Shih Shtojcat 3 dhe 4 (lista e konsulentëve ekspertë dhe personave të intervistuar).

<sup>7</sup> Qëndrimet e shprehura në këtë raport nuk i përfaqësojnë domosdo qëndrimet e OSBE-së, USOP, Departamentit të Drejtësisë së ShBA, apo Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut.

mund të arrihet në izolim, dhe ka një ndërgjegjësim të shtuar në mesin e vendeve të rajonit që bashkëpunimi ndërkombëtar luan një rol jetik në programin e suksesshëm për mbrojtje të dëshmitarëve, në zhvendosjen e dëshmitarëve, në këmbimin e informacioneve dhe për qëllime të tjera. Disa shtete në Evropën Juglindore, duke njohur këtë fakt, kanë nënshkruar konventën për asistencë të ndërsjellë në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve.<sup>8</sup> Në mënyrë që Kosova të marrë pjesë plotësisht në këto përpjekje rajonale, duhet të përmirësojë sistemin e saj për mbrojtjen e dëshmitarëve.

### **Korniza ekzistuese ligjore për mbrojtjen e dëshmitarëve në Kosovë**

Sipas precedentit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), jeta, liria apo siguria e dëshmitarëve nuk duhet të “rrezikohet në mënyrë të pajustificuar.”<sup>9</sup> Së këndejmi, autoritetet publike kanë për obligim të mbrojnë dëshmitarët dhe të afërmit e tyre të ngushtë nga ndërhyrjet, kërcënimet dhe rreziku, para, gjatë dhe pas gjykimit.<sup>10</sup> Mbrojtja efektive e dëshmitarëve është vendimtare për funksionimin e duhur të sistemit ligjor.<sup>11</sup>

#### ***a. Dispozitat për mbrojtjen e dëshmitarëve në Kodin e përkohshëm të procedurës penale të Kosovës***

Kodi i përkohshëm i procedurës penale të Kosovës (KPPPK) lejon fshehjen e identitetit të dëshmitarëve, dëgjime jo-publike, largimin e përkohshëm të pandehurit nga salla e gjykimit gjatë deponimit të dëshmisë nga dëshmitari, dëshminë nga largësia (p.sh., përmes video konferencës apo TV-së me qark të

<sup>8</sup> *Shih* Shtojcën 5 (ekstrakt nga Konventa për bashkëpunim policor për Evropën Juglindore).

<sup>9</sup> “Është e vërtetë që Neni 6 [...] nuk kërkon shprehimisht të merren parasysh interesat e dëshmitarëve në përgjithësi, dhe interesat e viktimave që ftohen për të dëshmuar në veçanti. Megjithatë, jeta e tyre, liria apo siguria e personit mund të vihen në pyetje, sikur që mund të jenë edhe interesat që përgjithësisht përfshihen në kuadër të Nenit 8 apo Konventës [...]. Ato interesa të dëshmitarëve dhe viktimave janë të mbrojtura në parim nga dispozitat tjera substanciale të Konventës, që lënë të kuptohet se Shtetet Kontraktuese duhet të organizojnë procedimet e tyre penale në atë mënyrë që të mos shkaktohet rrezikimi i atyre interesave në mënyrë të pajustificuar. Marrë parasysh këto, parimet e gjykimit të drejtë kërkojnë gjithashtu që në rastet e përshtatshme, interesat e mbrojtjes të balancohen me ato të dëshmitarëve apo viktimave që thirren për të dëshmuar.” Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Van Mechelen dhe të tjerët kundër Holandës*, 21363/93, 21364/93, 21427/93, 23 prill 1997, para.53; *Shih poashtu Doorson kundër Holandës*, 20524/92, 26 mars 1996, para.70; *P.S. kundër Gjermanisë*, 33900/96, 20 dhjetor 2001, para.22.

<sup>10</sup> “Ndërsa respektohen të drejtat e mbrojtjes, mbrojtja e dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe njerëzve të afërt me ta duhet të organizohet kur është e nevojshme, para, gjatë dhe pas gjykimit.” Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, Rekomandimi (2005)9 *Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë*, 20 prill 2005, Neni II(2). Për një pasqyrë të përgjithshme të çështjeve të përgjithshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale, shih Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimet, Grupi punues joformal për *Mbrojtjen e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë*, Vienë 22-24 shtator 2005.

<sup>11</sup> “[Është] e papranueshme që sistemi i drejtësisë penale të dështojë në sjelljen e të pandehurve për gjykim dhe të marrë vendimin, për shkak se dëshmitarët kanë qenë në mënyrë efektive të dekurajuar nga ofrimi i dëshmisë në mënyrë të lirë dhe të vërtetë.” Id., Preambula.

mbyllur), apo edhe ekzaminimin e regjistruar në video-kasetë para seancës gjyqësore, në praninë e avokatit mbrojtës.<sup>12</sup> Në dy prej lëndëve kryesore të GjEDNj-së është provuar që përdorimi i dëshmisë anonime nga një hetim, për sa kohë që i pandehuri apo përfaqësuesi ligjor i tij/saj kanë mundësinë t'i bëjnë pyetje dëshmitarit, nuk shkel domosdo të drejtën e të pandehurit nga Neni 6 për dëgjim të drejtë. Megjithatë, dënimi nuk duhet të bazohet asnjëherë vetëm apo "në masën" në bazë të deklarimeve anonime.<sup>13</sup> KPPPK e zbaton këtë udhëzim duke parashikuar që "[g]jykata nuk duhet të konstatojë fajësinë e të akuzuarit vetëm, apo deri në masën bindëse, në dëshminë e dhënë nga një dëshmitar i vetëm, identiteti i të cilit është anonim për palën mbrojtëse dhe të akuzuarin."<sup>14</sup>

Përdorimi i dëshmisë anonime mund të jetë problematik, veçmas kur dëshmitari nuk zhvendoset pas përfundimit të procedurës. Një nga arsyet themelore është që i pandehuri shpesh mund të supozojë identitetin e vërtetë të dëshmitarit anonim, bazuar në natyrën apo specifikat e dëshmisë. Veç kësaj, ashtu si përshkruhet më sipër, dënimi që bazohet "vetëm" apo "në masë bindëse" në dëshmitë anonime, mund të ngre shqetësimet sa i përket pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare për gjykim të drejtë.<sup>15</sup>

#### ***b. Problemet në implementimin e dispozitave të Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës për mbrojtjen e dëshmitarëve***

Përkundër disponueshmërisë së masave mbrojtëse në ligj, realiteti është që implementimi i tyre nuk funksionon gjithëherë si çështje praktike.<sup>16</sup> Për shembull, shumica e gjykatave nuk kanë hyrje të veçanta për dëshmitarët, që do

<sup>12</sup> Nenet 168 – 174, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK). Para miratimit të KPPPK-së, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/20 për mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve në procedimet penale, të datës 20 shtator 2001 (e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/1 të 24 janarit 2002) dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 2002/25 i datës 13 nëntor 2002, kanë siguruar masa për fshehjen e identitetit të dëshmitarëve gjatë deponimit të dëshmisë.

<sup>13</sup> *Shih Doorson kundër Holandës, supra* at 9, para.68-71 dhe *Kostovski kundër Holandës*, 11454/85, 20 nëntor 1989, para.44.

<sup>14</sup> Neni 157(3), KPPPK.

<sup>15</sup> Komiteti për të drejtat e njeriut ka ngritur poashtu shqetësimet e tij lidhur me faktin nëse përdorimi i dëshmitarëve anonimë është në pajtim me parimet e gjyqimit të drejtë, të mishëruara në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike (Shih Komiteti për të drejtat e njeriut, Vështrimet përmblyëse për Holandën (2001), UN doc. CCPR/CO/72/NET, para.12; shih poashtu Vështrimet përmblyëse për Kolumbinë (1997), UN doc. CCPR/C/79/Add. 75, para.21 dhe 40).

<sup>16</sup> Për shembull, në nëntor 2006, OSBE ka monitoruar një gjykim që kishte të bëjë me pretendimin e tentim vrasjes. Në seancën dëgjimore, dëshmitarët ishin ulur pranë të pandehurit dhe në dëshminë e tyre ishin në kundërshtim me deklaratat e mëparshme të dhëna me shkrim gjatë hetimit, dhe nuk konfirmonin deklaratimet e mëhershme me të cilat inkriminohej i akuzuari. Dëshmitarët më parë kishin deklaruar që i pandehuri kishte shtënë qëllimisht me armë ndaj tyre, që kishte shkaktuar plagosjen e disa personave. Nuk është e qartë nëse frikësimi i dëshmitarit, ndonjë marrëveshje anësore apo ndërhyrja nga familja/pajtimi, kanë shpënë në këtë ndryshim të dëshmisë. As gjyqtarët dhe as prokurori nuk kishin sugjeruar që dëshmitari të jap dëshminë e tij pa praninë e të pandehurit, ashtu si lejohet kjo me KPPPK, Neni 170(1) pika 7.

të ndihmonin në ruajtjen e fshehtësisë së tyre dhe t'i mbrojnë ata nga presioni publik apo vështrimi hetues. Veç kësaj, kjo situatë rëndohet nga sjelljet e papërgjegjshme të disa prej gazetave lokale, që në një numër rastesh kanë zbuluar identitetet e dëshmitarëve "anonimë". Në fund, ka pak ose aspak ndjekje penale të individëve që i kërcënojnë apo sulmojnë dëshmitarët, apo që bëjnë zbulimin e sekreteve zyrtare, domethënë identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur.

## KONKLuzionet nga vlerësimi

### Siguria fizike dhe zhvendosja e dëshmitarit

Programi i UNMIK-ut për mbrojtje të dëshmitarëve siguron mbrojtjen fizike të dëshmitarëve, para, gjatë dhe pas gjykimit, nga ana e njësisë së specializuar policore, e njohur si Njësia e UNMIK-ut për mbrojtje të dëshmitarëve (NjMD). Qarkorja e DD të UNMIK-ut Nr. 2003/5 *për Programin e mbrojtjes së dëshmitarëve* përshkruan me pak fjalë procedurat për futjen në Programin për mbrojtje të dëshmitarëve. Rekomandimet për futjen në program iniciohen nga prokurori apo gjyqtari, në bashkëveprim me njësinë hetuese përkatëse. Më pas, NjMD bën vlerësimin e rrezikut. Dëshmitari i nënshtrohet gjithashtu vlerësimit fizik e psikologjik për të përcaktuar nëse apo ajo mund të tolerojë stresin e të qenit në program. Nëse pranohet, dëshmitari dhe familja a afërt e tij apo saj transferohen në lokacion të sigurtë për kohën sa zgjatë gjykimi. Pasi të ketë përfunduar gjykimi, bëhet përpjekje për zhvendosjen e dëshmitarit jashtë Kosovës, përkohësisht apo në mënyrë të përhershme.<sup>17</sup> Megjithatë, përvoja e kaluar me programin ka rezultuar në vetëm një numër shumë të vogël të rasteve në të cilat dëshmitarët kyç janë zhvendosur me sukses.

Programi për mbrojtje të dëshmitarëve synon gjithashtu mbrojtjen e dëshmitarëve në rastet më serioze kriminale, sikur që është krimi i organizuar,<sup>18</sup> trafikimi i personave<sup>19</sup> dhe krimet e luftës.<sup>20</sup> Programi ka funksionuar pa një ligj të hollësishëm që drejton procedurat për futjen e dëshmitarëve në program, ndryshimin e identiteteve të tyre, dhe zhvendosjen e tyre jashtë Kosovës pasi të ketë mbaruar gjykimi. Aktualisht, baza e vetme ligjore e programit është një Qarkore dy faqëshe e DD të UNMIK-ut, që është e pamjaftueshme për rregullimin e këtij funksioni vital. Nevojitet një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse, dhe miratimi e implementimi i saj duhet të jetë një nga prioritetet më të larta. Janë dy versione të një projektligji të tillë (Versionet A dhe B – Shih Shtojca 2). Komentet për këto versione janë përfshirë në seksionin e Rekomandimeve në poshtë.

### Pengesat praktike në mbrojtjen e dëshmitarëve

<sup>17</sup> Qarkorja e DD të UNMIK-ut Nr. 2003/5 për Programin e mbrojtjes së dëshmitarëve.

<sup>18</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/25, *mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës* (KPPK), 6 korrik 2003, Nenet 274 dhe 310.

<sup>19</sup> Neni 139, KPPK.

<sup>20</sup> Shih Kapitulli XIV: Veprat penale kundër së drejtës ndërkombëtare, KPPK.



Mbrojtja e dëshmitarëve dhe inkurajimi i bashkëpunimit të tyre është gjë e vështirë në Kosovë, për disa arsye. Së pari, për shkak të madhësisë së vogël të Kosovës dhe lidhjeve të ngushta familjare, një numër relativisht i lartë i dëshmitarëve ka gjasa të njihen nga kryesit e supozuar dhe/apo nga publiku, dhe së këndejmi është më e mundur t'i nënshtrohen frikësimit dhe të kërkojnë mbrojtje. Prandaj, zhvendosja interne e dëshmitarëve nuk është një mjet efektiv për garantimin e sigurisë së tyre. Së dyti, historia e diskriminimit dhe shtypjes së banorëve të Kosovës nga autoritetet, i ka bërë ata mosbesues ndaj qeverisë dhe gjyqësisë në përgjithësi, dhe ngurrues për të shërbyer si dëshmitarë në rastet kriminale. Shumë prej banorëve të Kosovarës thjeshtë nuk besojnë që kanë obligim moral apo ligjor për të shërbyer si dëshmitarë në rastet kriminale.<sup>21</sup> Rrjedhimisht, zhvendosja jashtë Kosovës është mënyra e vetme për garantimin e sigurisë së disa prej dëshmitarëve, të cilët ndeshen me rrezikun e hakmarrjes nga të pandehurit apo bashkëpunëtorët e tyre kriminal.

Deri më tani, përpjekjet e NjMD-së për zhvendosjen e dëshmitarëve janë bërë në rend të parë përmes kanaleve joformale të komunikimit.<sup>22</sup> Ekipi vlerësues ka gjetur që NjMD vuan nga tri mangësi kryesore që e pengojnë efikasitetin e saj: mungesa e fondeve të mjaftueshme për të mbështetur kërkesat themelore të programit për mbrojtjen e dëshmitarëve; mungesa e ligjit gjithëpërfshirës për mbrojtjen e dëshmitarëve me të cilin do të rregullohej ky funksion vital dhe jashtëzakonisht i ndjeshëm, si dhe mungesa e policisë së specializuar vendore e ndërkombëtare me përvojë në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve.

Sipas Shefit të NjMD-së,<sup>23</sup> shumë probleme administrative paraqiten për shkak se buxheti i NjMD-së nuk është i ndarë nga institucionet tjera ndërkombëtare e vendore në Kosovë. Pjesa më e madhe e fondeve drejtohen përmes buxhetit të Shërbimit Policor të Kosovës (ShPK) apo entiteteve të tjera, duke shkaktuar kështu vonesa burokratike dhe duke penguar alokimin efikas të resurseve. Veç kësaj, struktura e tanishme organizative dhe administrative paraqet rreziqe të sigurisë për shkak se NjMD duhet të sigurojë fatura dhe dokumente të tjera për arsyetimin e shpenzimeve para institucioneve nga jashtë, që mund të vë në rrezik konfidencialitetin e aktiviteteve të NjMD-së dhe të rrezikojë sigurinë e dëshmitarëve të mbrojtur.

Një problem tjetër madhor lidhur me konfidencialitetin e operacioneve të NjMD-së është mungesa e sistemit të qartë për regjistrimin, ndarjen, ruajtjen dhe në fund shkatërrimin e informatave të ndjeshme që lidhen me aktivitetin e

---

<sup>21</sup> Neni 158 i KPPPK thotë: "Çdo person i thirrur si dëshmitar është i obliguar ti përgjigjet thirrjes dhe, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Kod [...] të dëshmojë." Neni 167 i KPPPK parasheh gjobë apo burgim për dëshmitarët që refuzojnë të paraqiten apo të dëshmojnë pa një arsyetim të ligjshëm.

<sup>22</sup> Sipas një interviste nga OSBE me Shefin e NjMD-së, ka pasur përpjekje të pasuksesshme për të bindur Komisionarin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM) për t'u angazhuar në zhvendosjen e dëshmitarëve.

<sup>23</sup> Intervista me Shefin e NjMD/UNMIK në shtator 2006.

NjMD-së dhe të dëshmitarëve të mbrojtur. Prandaj, informatat konfidenciale mund të dalin në shesh në rast të qarkullimit të tyre për shkaqe burokratike /interne. Kjo mund të vë në rrezik sigurinë e dëshmitarëve të mbrojtur. Ka dështime edhe në ruajtjen e duhur dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në rastet e ndryshimit të identitetit të dëshmitarëve të mbrojtur. Të punësuarit e Regjistrimit Civil janë përgjegjës për modifikimin e hollësive personale të dëshmitarëve të mbrojtur.<sup>24</sup> Këto mangësi duhet të adresohen në ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të koordinohen me projektligjin për të dhënat personale që aktualisht pret aprovimin në Kuvendin e Kosovës.

### **Përmirësimet e kohëve të fundit**

Të gjitha pesë Gjykatat e Qarkut në Kosovë janë pajisur së voni me teknologji të përmirësuar që mundëson mbrojtje të shtuar të dëshmitarëve, me fonde të dhuruara përmes zyrave ndërlidhëse të Britanisë së Madhe dhe Shteteve të Bashkuara në Prishtinë.<sup>25</sup> Këto sisteme përbëhen nga televizione me qark të mbyllur në secilën gjykatë, që u mundëson dëshmitarëve të dëshmojnë pa qenë fizikisht të pranishëm në sallën e gjykatës. Kjo teknologji siguron gjithashtu mundësi për modifikim të zërit dhe pamjes, për të fshehur identitetin e dëshmitarit. Veç kësaj, sistemi i ri u mundëson këtyre gjykatave të vendosin lidhje përmes video konferencës.<sup>26</sup> Këto përmirësime i zgjerojnë opsionet që janë në dispozicion për mbrojtjen e dëshmitarëve të rrezikuar apo dëshmitarët e lëndueshëm, sikur që janë të miturit apo viktimat e sulmeve seksuale. Mundësia e video konferencës nënkupton që tani është e mundur që dëshmitarët të ofrojnë dëshminë e tyre nga lokacione të ndryshme, me mundësi madje edhe nga jashtë Kosovës.

## **REKOMANDIMET**

### **Ndryshimet legislative**

Projektligji për Programin e mbrojtjes së dëshmitarëve është strukturuar për të mundësuar bazën ligjore për programin që ofron mbrojtje fizike, përfshirë këtu mundësinë e zhvendosjes së dëshmitarëve dhe personave të afërt me ta, që janë të rrezikuar si rezultat i dhënies së dëshmisë në procedurë penale. Aktualisht, këto shërbime lejohen sipas Qarkores së DD të UNMIK-ut 2003/5.

Të dy versionet e projektligjit nuk bëjnë ndërrimin e masave mbrojtëse që aktualisht janë në dispozicion sipas Kapitullit XXI (Nenet 168-74) të KPPPK-së, që i autorizon gjykatat për lëshimin e urdhrave me të cilat u lejohet dëshmitarëve të dëshmojnë në mënyrë anonime, mundësojnë mjete të tjera për fshehjen e

<sup>24</sup> Intervista e mbajtur nga OSBE me shefin e NjMD-së në tetor 2006.

<sup>25</sup> Njoftimi për shtyp nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 16 mars 2007.

<sup>26</sup> Video lidhjet në mes të gjykatave të qarkut kërkojnë shërbimin e ISDN (Rrjeti digjital i shërbimeve të integruara). Megjithatë, në kohën e instalimit, linjat e ISDN kanë qenë në dispozicion vetëm në Prishtinë dhe Prizren.

identitetit të tyre, përfshirë këtu përdorimin e pseudonimeve, si dhe për implementim të masave të tjera që sigurojnë mos zbulimin e identitetit të personit të rrezikuar gjatë kohës sa ata marrin pjesë në procedurat e gjykimit.

Si pjesë e misionit vlerësues, janë shqyrtuar të dyja versionet (A dhe B), bashkë me ligjet ekzistuese të Kosovës për mbrojtjen e dëshmitarëve. Ka një konsensus për nevojën e një ligji të ri për rregullimin e programit për mbrojtjen fizike, por Ekipi Vlerësues rekomandon një numër rishikimesh që duhen bërë para se të jetë miratuar ligji. Veç kësaj, planifikimi afatgjatë i dedikuar për zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për trajtimin e sigurisë dhe mbrojtjes së dëshmitarëve është i domosdoshëm. Në veçanti, Kosova duhet të marrë parasysh alternativa të tjera ndaj dëshmitarëve anonim. Thënë shkurt, ekipi rekomandon aprovimin e ligjit që përcakton strukturën dhe procedurat e një programi shumë të ngushtë të mbrojtjes së dëshmitarëve, për të mundësuar mbrojtjen fizike dhe në rastet ekstreme, zhvendosjen për dëshmitarët e rrezikuar dhe personat në lidhje të ngushtë me ta.

### ***Komentet për Versionet A dhe B të Projekt Rregullores për mbrojtjen e dëshmitarëve***

#### ***Versioni A:***

##### ***Neni 1***

Shprehja “paditës i autorizuar” nuk duhet të përfshijë paditësit privat. Rastet ku janë të përfshirë dëshmitarët dëshmia e të cilëve është mjaft kritike sa që justifikon futjen e tyre në program, do të jenë domosdo vetëm rastet që justifikojnë ndjekjen penale nga prokurori publik.

Përkufizimi i “anëtarit të familjes” duhet zëvendësuar me përkufizimin e “personave të tjerë të përshtatshëm në rrezik” që duhet të definohet si “anëtarët e familjes së ngushtë të dëshmitarit, përfshirë këtu bashkëshortin/en, fëmijët dhe prindërit, si dhe personat tjerë që do të rrezikoheshin për arsye të marrëdhënies së ngushtë të tij/saj me dëshmitarin.”

Shprehja “program për mbrojtjen e dëshmitarëve” duhet të definohet si një program ekskluziv i operuar nga njësi e policisë për mbrojtje të dëshmitarëve, për implementim të masave mbrojtëse për personat që i përmbushin kriteret për masat mbrojtëse, ashtu si parashihet në këtë ligj (dmth., përveç atyre që sigurohen nën Kapitullin XXI të KPPPK-së), dhe që kanë hyrë formalisht në program me marrëveshjen me shkrim.

Shprehja “person i mbrojtur” duhet të definohet si dëshmitari dhe/apo personat tjerë të përshtatshëm në rrezik që janë pranuar formalisht në programin për mbrojtje të dëshmitarëve dhe që kanë lidhur marrëveshje me shkrim me NjMD-në.

“Njësia për mbrojtje” duhet të definohet si njësi e specializuar në kuadër të policisë, përgjegjëse për vlerësimin e përshtatshmërisë fizike e psikologjike të personit për futje në program, dhe që merret me rekomandimin dhe implementimin e masave specifike, si dhe me administrimin e programit për mbrojtje të dëshmitarëve.

“Masa mbrojtëse” ashtu si definohet në këtë ligj, duhet të përfshijë vetëm masat që sigurohen nga NjMD, sipas ligjit aktual, dhe jo të përfshijë ato masa që sigurohen nga gjykata në pajtim me Kapitullin XXI të KPPPK-së.

“Marrëveshja protokol” duhet të definohet si marrëveshje me shkrim e nënshkruar nga NjMD dhe personi i mbrojtur apo përfaqësuesi i tij/saj, me të cilën rregullohet sigurimi i mbrojtjes personale gjatë kohëzgjatjes së qëndrimit të personit në programin e mbrojtjes.

“Rreziku serioz” duhet të definohet si frikë e justifikuar e rrezikut për jetën, shëndetin fizik apo mendor të dëshmitarit apo personit tjetër të përshtatshëm të rrezikuar, e konsideruar me arsye si pasojë e pritur e dëshmimit të tij/saj gjatë ekzaminimit apo dhënies së dëshmisë në cilëndo fazë të procedimit penal, përfshirë këtu fazën e hetimeve.

## ***Neni 2***

Në vend se të bëhet një listë e kategorive të rasteve për të cilat mund të jetë në dispozicion mbrojtja e dëshmitarëve, qasje më e mirë është që kjo t'i lihet lirisë së veprimit të prokurorit publik, në konsultim me zyrtarët dhe Njësinë për mbrojtje të dëshmitarëve, me përdorimin e kriterëve të paraqitura më poshtë në komentet për Nenin 3.

## ***Neni 3***

Vendimi për sigurimin e masave mbrojtëse fizike, sipas këtij projektligji i është lënë vendimit të gjykatës. Megjithatë, sigurimi i mbrojtjes fizike, në dritën e natyrës jashtë-gjyqësore të saj, nuk duhet të jetë vetëm vendim i gjykatës<sup>27</sup> pasi që gjykata nuk është në pozitën më të mirë për të bërë analizat e nevojshme për marrjen e këtij vendimi. Ky vendim, që zakonisht ngjan gjatë fazës së hetimit, shtron nevojën për vlerësim të nevojës së prokurorit për atë dëshmi dhe balancimin e kësaj me zotimin e resurseve që duhen alokuar për të ofruar sigurinë fizike dhe shërbimet tjera përkatëse. Këto elemente vlerësohen më së miri nga zyra e prokurorit dhe njësia për mbrojtje të dëshmitarëve, apo cilido entitet tjetër i ngarkuar me ofrimin e sigurisë fizike. Disa vende kanë formuar “komisione për mbrojtje të dëshmitarëve” të përbëra nga përfaqësuesit e agjencive të ndryshme, për të vepruar si organ vendimmarrës në konstatimin

---

<sup>27</sup> Për dallim nga kjo, masat mbrojtëse të urdhëruara nga gjykata dhe të cilat ndikojnë në mënyrën si merret dëshmia në procedimin gjyqësor, janë çështje që duhet të jenë nën kontrollin e gjykatës.

nëse dëshmitari i rrezikuar duhet të futet në program, ndërsa vendet tjera këtë vendim ia lënë në tërësi lirisë së veprimit të prokurorit. Ndërsa ka një varg modelesh të ndryshme, ka pak, ose aspak precedent për delegimin e këtij vendimi vetëm tek gjykata.<sup>28</sup> Shfrytëzimi i komisionit në përcaktimin e përshtatshmërisë për futje në program është më i pëlqyeshëm se delegimi i këtij vendimi në gjykatat. Duhet marrë parasysh rotacioni i kryesuesit të komisionit në mesin e përfaqësuesve nga organet e ndryshme që shërbejnë në komision.

Faktorët për futje në Programin për mbrojtje të dëshmitarëve, të numëruar nën 3.3, mbulojnë elementet e përgjithshme. Megjithatë, Ekipi Vlerësues rekomandon renditjen më të hollësishme të tyre, me sa vijon:

- Serioziteti i krimit;
- Rëndësia e ndjekjes penale dhe rëndësia e saj për Kosovën apo për interesat ndërkombëtare;
- Pështetshmëria e dëshmisë së dëshmitarit dhe nëse janë në dispozicion burimet alternative;
- Natyra, shkalla dhe lloji i kërcënimit ndaj dëshmitarit;
- Gatishmëria e dëshmitarit për të hyrë në program;
- Pështetshmëria fizike e psikologjike e dëshmitarit – marrja parasysh e çështjeve që do të ishin me interes për vendin pranues potencial, sikur që është dosja e gjerë penale, barrierat gjuhësore/kulturore dhe çështjet mjekësore apo psikologjike.

Përfshirja në draft e 3.3(c) që kërkon shqyrtimin e “ashpërsia e kërcënimit ndaj personit të mbrojtur, në masë të konsiderueshme peshon më tepër se kostoja financiare e vendosjes së personit të mbrojtur në programin për mbrojtje të dëshmitarëve” duhet të riformulohet në: “ashpërsia e kërcënimit ndaj personit të mbrojtur, në masë të konsiderueshme peshon më tepër se barra e vendosjes së personit të mbrojtur në programin për mbrojtje të dëshmitarëve.”

Veç kësaj, dispozita duhet të tregojë që këta faktorë do të çmohen nga prokurorët me përvojë dhe nga oficerët e policisë të NjMD-së. Gjithashtu, në vend të referimit në “personin e mbrojtur” në këtë fazë të procesit, dispozita duhet t’i referohet “dëshmitarit të rrezikuar” pasi që në atë fazë, nuk është vendosur ende që personi do të futet në program.

Nenet 3.4-3.6 duhet të ripunohen gjithashtu. Sikur që rekomandohet më sipër, ky vendim nuk duhet të jetë gjyqësor; në vend të kësaj, konstatimi duhet bërë nga prokurori publik, pas vlerësimit të hollësishëm nga profesionistët e mbrojtjes së dëshmitarëve (sikur që janë psikologët e të tjerët), apo nga komisioni i përbërë prej shumë agjencive, duke ndjekur kërkesat e përgjithshme procedurale të dhëna në nenet 3.5 dhe 3.6.

---

<sup>28</sup> *Shih* Shtojcën 6 (grafiku që krahason sistemet e mbrojtjes së dëshmitarëve në disa vende).

Faktorët e përmendur në nenin 3.7 (a) - (l) duhet të mbutohen nga kushtet e marrëveshjes protokoll me personin e mbrojtur, jo në vendim të gjykatës. Për më tepër, duhet të jetë e qartë që ofrimi i këtyre shërbimeve do të bëhet sipas konstatimit prej rastit në rast, ashtu si është e përshtatshme. Në masën sa ndonjë nga këta faktorë përfshin masat procedurale të rregulluara me Kapitullin XXI të KPPPK-së, ato duhet të adresohen në marrëveshje. Shërbimet tjera që mund të përfshihen për shqyrtim janë:

- shërbimet tjera ndihmëse sikur që është këshillimi psikologjik;
- asistenca në likuidimin e pasurisë reale dhe personale, apo në fshehjen e identitetit të pronësisë mbi atë pronë; dhe
- trajnimi për punësim.

### ***Neni 5***

Nën-neni (g)(3) do të formulohej më mirë si “për ndërmarrjen e të gjitha masave në dispozicion dhe që janë të përshtatshme . . .” pasi që nuk mund të ketë garanci që të gjitha masat *e nevojshme*, që nuk janë nën kontrollin e NjMD-së, do të mund të ndërmerren në të vërtetë.

### ***Neni 6***

Neni 6(f) duhet të zëvendësohet nga një dispozitë më e përgjithshme që lejon dhënien fund të futjes së personit në PMD, sikur që është “prokurori mund të kërkojë dhënien fund për shkaqe të mira, në interes të drejtësisë.” Frazja “pasi të jetë konstatuar nga gjyqtari apo paneli i gjyqtarëve që niveli i rrezikut ka pushuar së ekzistuari” në nenin 6(g) duhet të fshihet pasi që një shtet i huaj mund të mos ketë domosdo nevojë për një urdhër të tillë për t’i dhënë fund mbrojtjes.

## ***Versioni B:***

### ***Neni 4***

Ndërsa gjyqtarët luajnë një rol me rëndësi në të siguruarit që dëshmitarët e rrezikuar janë të mbrojtur gjatë procedurave të gjykimit, roli i tyre duhet të jetë më i kufizuar në marrjen e vendimit për futje në programin për mbrojtje të dëshmitarëve, në rastet kur kemi të bëjmë me sigurinë fizike afatgjate. Shih gjithashtu komentet për nenin 3 të versionit A, më sipër.

### ***Neni 5***

Komentet e njëjta sikur për nenin 3 të versionit A vlejnë edhe këtu.

### ***Neni 7***

Neni 7(2)(g)(iii) do të formulohej më mirë si “për ndërmarrjen e të gjitha masave në dispozicion dhe që janë të përshtatshme . . .” pasi që nuk mund të ketë garanci që të gjitha masat *e nevojshme*, që nuk janë nën kontrollin e NjMD-së, do të mund të ndërmerren në të vërtetë.

### ***Neni 8***

Në pajtim me komentet e bëra më sipër, entiteti me autoritet për dhënien fund të përfshirjes në program duhet të jetë i njëjtë sikur entiteti me autoritet vendimmarrës për pranimin e aplikantëve në program, por gjykata nuk është në pozitën më të mirë për ti marrë këto vendime. Komentet për nenin 6 në versionin A vlejnë edhe në këtë rast.

### ***Neni 9***

Neni 9 duhet të përfshijë dispozitën e përgjithshme për ruajtje të informatave lidhur me personat që janë duke u marrë parasysh për futje në programin për mbrojtje të dëshmitarëve, si dhe për persona që janë pranuar për përfshirje në program. Ato informata duhet të ruhen mirë nga zbulimi i paautorizuar, gjatë të gjitha fazave të pjesëmarrjes së personit. Veç kësaj, ligji duhet t'i konsiderojë si të kundërligjshme, me ndëshkimet përkatëse, të gjitha format e kanosjes së dëshmitarit dhe zbulimit të paautorizuar të informatave që kanë të bëjnë me identitetin e personave që marrin pjesë në program.

### ***Neni 12***

Neni 12 duhet t'i lejojë Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm apo autoritetit pasues të tij delegimin e detyrës për hartimin e një Udhëzimi Administrativ – apo direktivave të tjera implementuese dhe udhërrëfytesve – për Ministrinë relevante.

### ***Rekomandimet tjera për çështjet legjislative***

- Dënimet penale për kërcënimet e bëra dëshmitarëve duhet të përforcohen dhe të zgjerohen në Nenet 309 dhe 310 të KPPPK-së, dhe jo të kufizohen vetëm në disa lloje të caktuara të rasteve.
- Dënimet penale duhet të strukturohen për të ofruar nxitje që i inkurajojnë të pandehurit për të bashkëpunuar me zbatuesit e ligjit. Për shembull, kjo mund të marrë formën e dënimit të zvogëluar në këmbim të pajtimit të të pandehurit për tu deklaruar fajtor dhe për të bashkëpunuar me autoritetet. Njëkohësisht, dënimet për të pandehurit mos-bashkëpunues duhet

gjithashtu të jenë mjaft të larta sa për të lejuar reduktimet e tilla për të pandehurit bashkëpunues.

- KPPPK duhet të ndryshohet për t'u mundësuar autorizim eksplisit të pandehurve që të lidhin marrëveshje me prokurorin, për tu deklaruar fajtor dhe për të bashkëpunuar.<sup>29</sup>
- Të merret parasysh miratimi i legjislacionit që do të adresonte nevojat afatshkurtra dhe emergjente të dëshmitarëve të rrezikuar që nuk ngriten në nivelin e mbrojtjes së kërkuar në programin më formal të mbrojtjes së dëshmitarëve, por që mund të administrohen përmes Zyrës së Prokurorit Publik.

### **Ndryshimet programatike**

Performansa e NjMD-së së UNMIK-ut në ofrimin e mbrojtjes kryesisht të hapur të një numri të kufizuar të dëshmitarëve të kërcënuar, ka qenë adekuate në disa raste dhe jo adekuate në të tjerat. Ende ka një hendek të madh dhe të papranueshëm në mes asaj që kërkohet dhe asaj që mund të ofrohet. Disa çështje themelore duhet të adresohen me qëllim të rritjes së nivelit të sigurisë dhe të mbrojtjes për dëshmitarët.

#### **a. Eksperienca dhe trajnimi**

**Rekomandimi 1:** Qarkullimi i madh i personelit në NjMD ndikon në mënyrë të pafavorshme në operacionet e saj. UNMIK-u apo dhe menaxhmenti dhe oficerët e Shërbimit Policor të Kosovës që punojnë në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e dëshmitarëve, duhet të emërohen për mandate afatgjate (të paktën dy vite) për t'u mundësuar atyre të zhvillojnë ekspertizën dhe përvojën në këtë fushë jashtëzakonisht komplekse.

**Rekomandimi 2:** Së fundi, mungesa e vazhdimësisë do të vështirësojë gjithashtu edhe tranzicionin e detyrave për sigurim dhe mbrojtje të dëshmitarëve nga misioni i drejtuar kryesisht nga ndërkombëtarët, në misionin që do të drejtohej nga ShPK-ja, përveç nëse bëhen përpjekje për zhvillimin dhe implementimin e njëkohshëm të NjMD-së së administruar nga ShPK-ja në Kosovë. Sidoqoftë, për shkak të natyrës së ndjeshme të mbrojtjes së dëshmitarëve, vetëm një numër shumë i vogël i menaxhmentit dhe oficerëve të stafit të ShPK-së do të duhej përfshirë këtu. Këta individë duhet të identifikohen dhe verifikohen në imtësi, dhe më pas të fillohet me "krijimin e hijeve" të stafit ndërkombëtar të NjMD-së. Kjo duhet të fillojë sa më parë që është e mundur. në

---

<sup>29</sup> Shih dispozitën e propozuar për rregullim të marrëveshjeve për deklarimin e fajësisë, në Shtojcën 7. Kjo draft dispozitë për rregullimin e marrëveshjeve për deklarim të fajësisë është dorëzuar si propozim i përbashkët tek Ministri i Drejtësisë në mars të vitit 2007, nga Oda e Avokatëve, Asociacioni i Gjyqtarëve të Kosovës dhe Asociacioni i Prokurorëve Publik të Kosovës.



mënyrë ideale, vetëm rekrutët e rinj apo të angazhuar së fundi të ShPK-së do të duhej zgjedhur për këtë detyrë.

**Rekomandimi 3:** I tërë stafi duhet të jetë i trajnuar në mënyrë adekuate në fushat kyçe të sigurisë së dëshmitarëve për të cilat janë përgjegjës ata – për shembull, kryerja e vlerësimeve psikologjike dhe të rrezikut, ofrimi i mbrojtjes së afërt, e kështu me radhë. Sa herë që është e mundur, mundësitë për trajnime të tilla duhet të koordinohen me profesionistët tjerë të mbrojtjes së dëshmitarëve në rajon, me qëllim të ngritjes së rrjeteve të nevojshme për përmirësimin e bashkëpunimit rajonal dhe për këmbimin e “praktikave më të mira.”

#### ***b. Siguria e objekteve të gjykatave dhe qendrave të paraburgimit***

**Rekomandimi 4:** Programi efektiv për siguri të dëshmitarëve duhet të mbështetet gjithashtu në ekzistencën e masave dhe procedurave adekuate të sigurisë në gjykata. Masat e sigurisë në gjykata që janë aktualisht në dispozicion në Kosovë janë të dobëta apo nuk ekzistojnë fare. Iniciativa për trajnim dhe implementim të sigurisë së gjykatave duhet të ndërmerret në ndërthurje me zhvillimin, implementimin dhe administrimin e programit për mbrojtje të dëshmitarëve.

**Rekomandimi 5:** “Komiteti për sigurinë e gjykatave” duhet të formohet në secilin distrikt, dhe të jetë i përbërë nga gjyqtari kryesor, prokurori kryesor, zyrtari kryesor i zbatimit të ligjit si dhe nga inxhinieri apo mbikëqyrësi i objektit. Ky komitet do të ishte përgjegjës për marrjen e drejtimit në identifikimin e boshllëqeve në sigurinë e gjykatave dhe për zhvillimin e zgjidhjeve të përshtatshme, në konsultim me specialistët kur kjo është e mundur. Kjo mund të përfshijë ngritjen e hyrjeve speciale dhe lokaleve të ndara për dëshmitarët e rrezikuar dhe/apo të mbrojtur. Këto komitete rajonale duhet të bëjnë koordinimin e përpjekjeve të tyre, për të dalë me standardet minimale që do të ishin të zbatueshme në të gjitha gjykatat, me qëllim të sigurimit të një niveli të caktuar të pajtueshmërisë.

**Rekomandimi 6:** Ofrimi i trajnimit për siguri për të gjithë pjesëtarët e personelit të gjykatave – gjyqtarët, përfaqësuesit ligjor, nëpunësit, stafin administrativ dhe rojet. Ky trajnim do të duhej të mbulonte sigurinë personale dhe të edukojë personelin e gjykatës për metodat dhe aftësitë e NjMD-së.

**Rekomandimi 7:** Hartimi i listës kontrolluese të treguesve që do të shtronin nevojën për masa mbrojtëse për gjyqtarët e kërcënuar dhe stafin tjetër të gjykatës.

**Rekomandimi 8:** Veçimi i bashkëpunëtorëve të drejtësisë që janë futur në programin e mbrojtjes, nga popullata e përgjithshme e burgjeve, në kthina të sigurta dhe të veçuara të burgjeve.

### **c. Çështjet e rëndësisë kritike**

**Rekomandimi 9:** Mbrojtja e dëshmitarëve është një ndërmarrje qenësisht e shtrenjtë – mund të kërkojë personel të pandërprerë për periudha të gjata, vetura, shtëpi të sigurta, shërbime ndihmëse përcjellëse dhe një varg pajisjesh. NjMD duhet të financohet që më parë në secilin vit. Financimi i aktiviteteve të sigurisë nuk mund të përcaktohet në bazë të rasteve veç e veç. Fondet duhet të alokohen në secilin vit fiskal (kostoja pasqyron vetëm pagesat që bëhen drejtpërdrejtë apo në emër të personave të mbrojtur; kostoja nuk duhet të përfshijë pagat dhe shpenzimet e stafit), dhe mund të kategorizohet me sa vijon:

- Pagesat ditore për mjetet e jetesës
- Kostoja e banimit
- Shpenzimet mjekësore –vetëm ato afatshkurtra
- Shpenzimet e dokumentacionit
- Shpenzimet e udhëtimit
- Kostoja e blerjes apo zëvendësimit të të mirave shtëpiake
- Shpenzimet edukative/të aftësimit profesional
- Kostot e llojlojshme

**Rekomandimi 10:** T'i mundësohet NjMD-së kryerja e prokurimeve në mënyrën që shmangë zbulimin e informatave konfidenciale apo që në një mënyrë tjetër zbulon para palëve të treta ofruese, që ato prokurime janë për dëshmitarët e mbrojtur.

### **d. Modeli i mundshëm për NjMD-në**

**Rekomandimi 11:** Rekomandimi i ekipit vlerësues është që programi për siguri dhe mbrojtje të dëshmitarëve në Kosovë duhet t'i ketë të gjitha shërbimet në kuadër të një zyre, brenda shtyllës së operacioneve të policisë, dhe që do të siguronte shkallën e plotë të shërbimeve të duhura mbrojtëse – për shembull, asistencë me shkathtësitë jetësore, këshillimi social/psikologjik, ridookumentimi, mbrojtja e hapur/e fshehtë, zhvendosja jashtë vendit apo ndonjë kombinim i përshtatshëm i këtyre. NjMD duhet të ketë autoritetin e saj të prokurimit.

**Rekomandimi 12:** Të shqyrtohet ngritja e një objekti të dedikuar e të përhershëm për mbrojtjen fizike afatshkurtër të dëshmitarëve të rrezikuar dhe anëtarëve të ngushtë të familjeve të tyre. Mbështetja në shtëpitë e sigurta të marra me qira, ngre një mori problemesh logjistike e administrative, përfshirë këtu vështirësitë rreth ruajtjes së fshehtësisë së lokacioneve të shtëpive të sigurta. Në vend të kësaj, një ndërtesë më e përhershme që është e ruajtur më mirë dhe që ka kthina mjaft të mëdha për ofrim të shërbimeve më të mira – sikur që është

zyra mjekësore në vendndodhje dhe hapësira rekreative – mund të jetë një opsion më i mirë dhe më efektiv sa i përket kostos, në një periudhë afatgjate.

**Rekomandimi 13:** Duhet të ekzistojë bashkëpunim i ngushtë në mes të zyrës së prokurorit publik dhe njësisë për mbrojtje të dëshmitarëve në të gjitha aspektet e operimit të programit.

**Rekomandimi 14:** Të shqyrtohet themelimi i fondit special nga asetet e konfiskuara, që do të mund të përdorej për plotësimin e shërbimeve për dëshmitarët viktima, që mbulohet nga buxheti vjetor.

**Rekomandimi 15:** Të shqyrtohet vënia e rregullave të reja, të përgatitura në mënyrë specifike për të rregulluar sistemin e regjistrimit, këmbimit, ruajtjes dhe shkatërrimit të informatave që lidhen me funksionet e mbrojtjes së dëshmitarëve.

#### ***e. Zhvendosja jashtë vendit***

**Rekomandimi 16:** Marrë parasysh territorin e vogël të Kosovës dhe komunitetet e lidhura ngushtë, dëshmitarët nën kërcënime serioze, kanë nevojë reale për zhvendosje jashtë vendit në mënyrë që të mundësohet siguria e tyre. Megjithatë, ky mjet është veçmas problematik për disa arsye. Pikë së pari, implementimi i duhur i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimeve varet në masë të madhe nga rrjetet personale të ngritura gjatë kohës, në mesin e një komuniteti shumë të vogël të profesionistëve për mbrojtje të dëshmitarëve. NjMD e UNMIK-ut nuk ka zhvilluar ende rrjetet e nevojshme me njësitë e themeluara për mbrojtje të dëshmitarëve në vendet e Ballkanit apo pjesën tjetër të Evropës. Në masë të madhe kjo është për shkak të qarkullimit të madh të personelit. Së këndejmi, mundësitë për avancime brenda kësaj njësie dhe përfitimet shtesë duhet të jenë prioritet, për të inkurajuar ruajtjen e personelit.

**Rekomandimi 17:** Kosova duhet të fillojë me implementimin e “zyrës për planifikim e zhvendosjes jashtë vendit” në kuadër të NjMD-së së saj, pa marrë parasysh nëse NjMD drejtohet nga ShPK-ja apo nga një mision ndërkombëtar.

## KONKLUZION

Përvoja e shumë vendeve demonstroi që masat efektive për mundjen e grupeve të organizuara kriminale kërkojnë bashkëpunim të kriminelëve që janë të gatshëm të bashkëpunojnë me zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe të dëshmojnë kundër bashkëpunëtorëve të tyre. Një bashkëpunim i tillë është i pamundur pa aftësinë e prokurorëve dhe zyrtarëve për zbatim të ligjit për ofrim të mbrojtjes së mjaftueshme për këta individë. Veç kësaj, dëshmitarët viktimë duhet të kenë mbrojtje adekuate për të inkurajuar pjesëmarrjen e plotë të tyre në procedurat penale. Për Kosovën, kjo do të shtrojë nevojën e nxjerrjes së legjislacionit që ofron bazë të shëndoshë ligjore për mbrojtjen e dëshmitarëve, si dhe krijimin dhe financimin adekuat të strukturave institucionale për implementim të një programi gjithëpërfshirës si ky. Pa mjete efektive për mbrojtje të dëshmitarëve, qofshin ata viktimë apo të pandehur bashkëpunues, Kosova nuk mund të shpresojë në arritjen e progresit domethënës në ndjekjen e krimit të organizuar dhe krimeve të tjera serioze.

## SHTOJCAT

- 1 Qarkorja e DD të UNMIK-ut 2003/5
- 2 Draftet e Versioneve (A dhe B) të Rregullores për Programin e mbrojtjes së dëshmitarëve
- 3 Lista e Ekspertëve të Ekipit Vlerësues
- 4 Lista e personave të intervistuar dhe lokacioneve të vizituara
- 5 Konventa për bashkëpunimin policor për Evropën Juglindore (ekstrakt – Neni 10)
- 6 Grafiku krahasues i Programeve për mbrojtje të dëshmitarëve
- 7 Drafti i shtesave në dispozitat relevante të Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal të Kosovës për lejimin e marrëveshjes së negociuar mbi fajësinë

# SHTOJCA

1



**Programi i Mbrojtjes së Dëshmitarit**  
**Referencë: Justice/2003/5**

1. Kjo qarkore parashtron procedurën e ndjekur nga Njësia e Mbrojtjes së Dëshmitarit (NjMD) të Policisë së UNMIK-ut/SHPK-së në lidhje me Programin e Mbrojtjes së Dëshmitarit ("Programi").
2. Termi "dëshmitar" përkufizohet në seksionin 1 (b) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/20 Mbi Mbrojtjen e Palëve të Dëmtuara dhe Dëshmitarëve në Procedura Penale ("Rregullorja") që i referohet një personi " i cili thirret, ose ka njohuri përkatëse dhe mund të thirret për të dëshmuar përpara gjykatës, ose një person të cilit gjykata l'a ka përmendur emrin si dëshmitar që do të thirret".
3. NjMD ka përgjegjësinë për të mbrojtur dëshmitarët të cënueshëm [vulnerable] përpara dhe pas dëshmisë së tyre në gjykatë duke i transferuar ato në vende të siguruara e të fshehta. Megjithatë, duhet të theksohet që NjMD-ja gjithashtu mund të analizojë mundësitë rast pas rasti dhe mund të përdorë një alternative në vend të regjistrimit në Program.

**Rekomandim për regjistrim**

4. Për të regjistruar një dëshmitar në Program, prokurori ose gjyqtari pas konsultimit ose me Njësinë Qëndrore të Hetimeve Penale (NjQH), Zyrën e Krimit të Organizuar të Kosovës (ZKOK), ose Njësia e Hetimit të Personave të Trafikuar (NjHPT) duhet të bëjë një rekomandim me shkrim NjMD-së duke deklaruar arsyet që beson se dëshmitari është ose mund të jetë në rrezik serioz fizik.
5. Seksioni 1 (c) i Rregullores parashikon përkufizimin e "rrezikut serioz" si "frikë e justifikuar për kanosje të jetës, shëndetit ose pasurisë të palës së dëmtuar ose dëshmitarit si një rrjedhojë e pritshme nga dhënia e informacionit gjatë një marrjeje në pyetje ose dhënie dëshmie para gjykatës së një dëshmitari apo pale të dëmtuar".

**Vlerësim**

6. Sapo të merret rekomandimi nga NjMD, një hetues i vlerësimit të kanosjes do të vlerësojë në mënyrë të pavarur faktorët e mundshëm të rrezikut për dëshmitarin përkatës. Nëse NjMD-ja përcakton që dëshmitari është i pranueshëm për Programin e Mbrojtjes së Dëshmitarit, dëshmitari do të nënshtrohet një tjetër vlerësimi për të përcaktuar përshtatshmërinë e tij ose të saj për Programin.
7. Gjatë kësaj periudhe vlerësimi, NjMD-ja do ta transferojë dëshmitarin në një vend të ndërmjetëm. Dëshmitari do t'i nënshtrohet analizave psikologjike dhe fizike për të përcaktuar nëse ai ose ajo është në gjendje për të duruar streset e veçanta që shoqërojnë të qenurit brenda

Programit.

8. Në qoftë se, gjatë periudhës së vlerësimit, NjMD-ja vlerëson që dëshmitari është i papërgatitur ose i papërshtatshëm për masat e rrepta të mbrojtjes afatgjatë, dëshmitari do të tërhiqet nga Programi. Dëshmitari mundet, në çdo kohë, të tërhiqet vullnetarisht.

#### Transferimi në vend të sigurtë

9. Nëse NjMD-ja pas vlerësimit përcakton që dëshmitari është i përshtatshëm për Programin, dëshmitari dhe familja e afërt e tij ose e saj zhvendosen në një vend të sigurtë në Kosovë. Ky vend ka kapacitet tepër të kufizuar për të strehuar dëshmitarët dhe familjet e tyre, që mund të jetë një arsye për NjMD-në për të konsideruar alternativa për regjistrim në program, siç është e cekur në paragrafin 3.
10. Dëshmitari dhe familja e tij ose e saj do të mbeten në qendrën e sigurtë për të gjithë periudhën e gjyqit dhe kohën e nevojshme për rivendosje që do të organizohet, sikurse përshkruhet në paragrafin 11 më poshtë. Megjithatë, dëshmitari mundet në çdo kohë, prapë të tërhiqet vullnetarisht nga Programi.

#### Zhvendosja

11. Pas përfundimit të procedurave penale, NjMD-ja kërkon të zhvendosë përkohësisht ose përhërë dëshmitarin dhe familjen e tij apo saj jashtë Kosovës. Dëshmitarë të tillë zhvendosen në çdo vend të huaj i gatshëm për ti pranuar ato. Vendi pritës do të bëjë proqatitje për dëshmitarin, të tilla si akomodimin dhe trainimin, dhe atyre nuk do t'u takojë regjistrimi i mëtejshëm në programin e mbrojtjes së dëshmitarit të vendit pritës.
12. Është e domosdoshme që dëshmitarët të mos keqkuptojnë që të besojnë se atyre u garantohej zhvendosja jashtë Kosovës ose që ato mund të zgjedhin vendin në të cilin ato mund të zhvendosen.

Paul E. Coffey  
Drejtor  
Departamenti i Drejtësisë

Për: Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës  
Kryetarin e Gjykatës së Lartë për Kundravajtje  
Të gjithë Kryetarët e Gjykatave të Qarkut  
Të gjithë Kryetarët e Gjykatave Komunale  
Të gjithë Kryetarët e Gjykatave për kundravajtje  
Prokurori Publik i Kosovës  
Të gjithë Prokurorët Publik të Qarkut  
Të gjithë Prokurorët Publikë Komunalë

Cc: Z. Stephen Feller, Komisioner i Policisë së UNMIK-ut  
Z. Larry Inmon, Shef, Njësia e Mbrojtjes së Dëshmitarit



SHTOJCA

2

VERSIONI A



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TE VETËQEVERISJES  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVE

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

Vendim Nr 2006/XX

**PËR PROGRAMIN E MBROJTJES SË DËSHMITARËVE**

Kuvendi i Kosovës,

Në përputhje me autoritetin e dhënë sipas nenit 9.1.26(a), 9.1.27,9.1.45 të Komizës Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9) dhe aneksi XV(i) i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/53, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Duke njohur që kërcënimi i palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve dëmton në masë të madhe përpjekjet për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të krimeve serioze në Kosovë, përfshirë këtu krimet e luftës, krimet ndër-etnike, terrorizmin dhe krimin e organizuar, dhe përbën pengesë në vendosjen e sundimit të ligjit në Kosovë, dhe

Me qëllim të themelimit të programit për mbrojtje të dëshmitarëve, si masë mbrojtëse shtesë për garantimin e mbrojtjes dhe sigurisë së palës së dëmtuar apo dëshmitarit, apo anëtarit të familjes, gjatë dhe pas procedimit penal,

Me anë të kësaj shpall me sa vijon,

**RREGULLORE PËR PROGRAMIN E MBROJTJES SË DËSHMITARËVE**

Neni 1  
Definicionet

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje:

(1) Shprehja “paditës i autorizuar” nënkupton prokurorin publik, paditësin privat, apo paditësin shtesë.

(2) Shprehja “anëtar i familjes” nënkupton bashkëshortin/en, partnerin jashtëmartesor, lidhjen e gjakut në vijë direkte, prindin adoptues, fëmijën e birësuar, vëllain, motrën, apo prindin birësues.

(3) Shprehja “palë e dëmtuar” nënkupton personin, të drejtat personale apo pronësore të të cilit janë shkelur apo rrezikuar nga vepra penale.

(4) Shprehja “gjuqtar” nënkupton gjuqtarin e procedurës paraprake apo gjuqtarin drejtues.

(5) Shprehja “polici” nënkupton Policinë Civile të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, e njohur gjithashtu si Policia Ndërkombëtare e OKB-së, dhe Shërbimin Policor të Kosovës. Do të përfshijë edhe policinë gjyqësore.

(6) Shprehja “person i mbrojtur” nënkupton palën e dëmtuar, dëshmitarin apo anëtarin e familjes që është i kërcënuar dhe është urdhëruar të vendoset në programin e mbrojtjes, në bazë të frikës së bazuar të rrezikut për jetën e tij apo saj, shëndetin fizik dhe mendor apo pronën, si pasojë e pritur e dëshmimit të tij apo saj gjatë ekzaminimit apo deponimit të dëshmisë, në cilëndo fazë të procedimeve penale, me nënshkrimin e marrëveshjes protokoll me njësinë policore që bën mbrojtjen.

(7) Shprehja “program për mbrojtje të dëshmitarëve” nënkupton programin ekskluziv që operohet nga policia për implementimin dhe ekzekutimin e masave mbrojtëse të urdhëruara nga gjykata, në mbrojtje të jetës, shëndetit, lirisë dhe pronës së palës së dëmtuar, dëshmitarit dhe anëtarit të familjes, gjatë dhe pas procedurës penale.

(8) Shprehja “njësi mbrojtëse” nënkupton njësinë e specializuar në kuadër të policisë me përgjegjësi për rekomandimin dhe implementimin e masave mbrojtëse, dhe për operimin e programit për mbrojtje të dëshmitarëve.

(9) Shprehja “masë mbrojtëse” nënkupton masën e urdhëruar nga gjykata me qëllim të mbrojtjes së palës së dëmtuar, dëshmitarit, apo anëtarit të familjes, gjatë dhe pas procedurës penale, ashtu si parashihet me ligjin e zbatueshëm.

(10) Shprehja “rrezik serioz” nënkupton frikën e përligjur nga rreziku për jetën, shëndetin fizik apo mendor të palës së dëmtuar, dëshmitarit apo anëtarit të familjes së palës së dëmtuar apo të dëshmitarit, si një pasojë e pritur nga dëshmimi i palës së dëmtuar apo dëshmitarit gjatë ekzaminimit apo deponimit të dëshmisë në gjykatë, apo gjatë një hetimi.

(11) Shprehja ‘marrëveshje protokoll’ nënkupton marrëveshjen me shkrim, të nënshkruar nga njësi mbrojtëse e policisë dhe nga personi i kërcënuar, që rregullon ofrimin e mbrojtjes personale gjatë kohëzgjatjes së qëndrimit në programin për mbrojtje të dëshmitarëve.

Neni 2  
Shtrirja e Rregullores

Kjo rregullore përcakton procedurat me të cilat rregullohet urdhri për regjistrimin e një personi të mbrojtur në programin për mbrojtje të dëshmitarëve, gjatë dhe pas procedurës penale, dhe do të zbatohet vetëm nëse një apo më shumë nga veprat penale në vijim nuk do të provohen pa dëshminë e personit të mbrojtur:

- (a) Veprat penale kundër Kosovës dhe banorëve të saj;
- (b) Veprat penale kundër së drejtës ndërkombëtare;
- (c) Veprat penale të kryera në mënyrë të organizuar; dhe
- (d) Veprat penale të dënueshme me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) apo më shumë vitesh.

Neni 3  
Programi për mbrojtjen e dëshmitarëve

3.1 Në cilëndo fazë të procedimeve penale, paditësi i autorizuar, i pandehuri, avokati mbrojtës, apo personi i mbrojtur, mund të bëjnë kërkesë me shkrim të drejtuar gjyqtarit apo panelit të gjyqtarëve, për regjistrim në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, nën autoritetin dhe administrimin e njësisë mbrojtëse të policisë.

3.2 Dispozitat e Kapitullit XXI të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës me të cilat rregullohet kërkesa për masën mbrojtëse, do të zbatohen gjithashtu *mutatis mutandis* për kërkesën e bërë në pajtim me këtë nen.

3.3 Kur masat mbrojtëse të urdhëruara sipas Kapitullit XXI të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës janë të pamjaftueshme për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e personit të mbrojtur, gjyqtari apo paneli i gjyqtarëve mund të urdhërojnë në rrethana detyruese që personi i mbrojtur të regjistrohet në programin për mbrojtje të dëshmitarëve, pasi të kenë konstatuar që:

- (a) Ekziston nivel jashtëzakonisht i lartë i rrezikut për personin e mbrojtur;
- (b) Dëshmia e personit të mbrojtur është tepër e rëndësishme për çështjen materiale në shqyrtim, që në mungesë të saj, mund të ndikojë në thelb në gjetjet e gjykatës; dhe

- (c) Ashpërsia e kërcënimit për personin e mbrojtur, në masë të konsiderueshme peshon më tepër se kostoja financiare e vendosjes së personit të mbrojtur në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve.

3.4 Para dhënies së urdhrin sipas këtij neni, gjyqtari apo paneli i gjyqtarëve do të mbajnë dëgjimin në seancë të mbyllur, në të cilën do të ekzaminohen personi i mbrojtur në fjalë dhe personat tjerë që konsiderohen të domosdoshëm, sikur që është policia apo personeli ushtarak që ofron sigurinë. Përveç këtyre personave, vetëm paditësi i autorizuar, personeli esencial i gjykatës dhe prokurorisë si dhe avokati mbrojtës mund të jenë të pranishëm.

3.5 Gjyqtari apo paneli i gjyqtarëve mund t'i kërkojnë njësisë mbrojtëse dorëzimin e një vlerësimi të pavarur, në afat prej dyzet e tetë orësh (48) nëse ekziston një nivel jashtëzakonisht i lartë i rrezikut për personin e mbrojtur, që justifikon regjistrimin në programin për mbrojtje të dëshmitarëve. Gjatë kësaj periudhe të vlerësimit, personi i mbrojtur mund t'u nënshtrohet ekzaminimeve psikologjike e fizike, për të përcaktuar nëse ai apo ajo është në gjendje t'u bëj ballë efekteve të regjistrimit në programin për mbrojtje të dëshmitarëve.

3.6 Gjyqtari apo paneli i gjyqtarëve do të marrin vendim rreth kërkesës në afat prej dyzet e tetë orësh (48) pas përfundimit të seancës dëgjimore.

3.7 Urdhri i lëshuar sipas këtij neni do të ofrojë masa plotësuese si më poshtë:

- (a) mbrojtja fizike e personit të kërcënuar dhe pronës;
- (b) zhvendosja në vend të sigurtë;
- (c) mbrojtja e përkohshme e identitetit, informatave dhe dokumenteve të personit të mbrojtur;
- (d) rehabilitimi social;
- (e) rikualifikimi profesional;
- (f) ndërrimi i identitetit;
- (g) mbajtja, ndërrimi i vendit të punës dhe punësimi i përkohshëm;
- (h) asistenca ligjore;
- (i) asistenca financiare për periudhën kohore të qëndrimit në program;

- (j) mbrojtja dhe trajtimi special në rastet ku i akuzuari është vendosur në entin korrektues, si masë sigurie para gjykimit apo kur është i dënuar me burgim;
- (k) deklaratimet e dëshmitarit nën një identitet tjetër dhe administrimi i tyre me mjete speciale për deformim të zërit dhe mos-shfaqje; dhe
- (l) masat speciale fizike e teknike të mbrojtjes në vendin ku banon personi dhe gjatë të gjitha transportimeve.

3.8 Njësia mbrojtëse e policisë do të zbatojë masat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

#### Neni 4 Njësia mbrojtëse

Njësia mbrojtëse e policisë do të ketë përgjegjësitë në vijim:

- (a) të bëjë rekomandime për gjyqtarin apo panelin e gjyqtarëve lidhur me atë nëse personi i mbrojtur duhet të regjistrohet në programin për mbrojtje të dëshmitarëve, në bazë të vlerësimit të kërcënimit të kërkuar nga gjykata dhe në bazë të resurseve në dispozicion;
- (b) të dorëzojë raportin vjetor të buxhetit tek Komisionari i Policisë, lidhur me koston financiare të operimit të programit për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- (c) të lidhë Marrëveshjen protokoll me personin e mbrojtur;
- (d) të ekzekutojë urdhrin për regjistrimin e personit të mbrojtur në programin për mbrojtje të dëshmitarëve, të lëshuar sipas kësaj Rregulloreje;
- (e) të miratojë procedurat standarde operative për zbatimin e masave mbrojtëse, me përfshirjen e procedurave për ruajtjen e të gjitha informacioneve që kanë të bëjnë me ofrimin e atyre masave për personat e mbrojtur;
- (f) të ruajë dokumentet origjinale të personit me identitet të maskuar apo të ndërruar; dhe
- (g) të sigurojë praninë e personave të mbrojtur gjatë procedimeve penale.

#### Neni 5 Marrëveshja protokoll

4.1 Në afat prej shtatë (7) ditësh nga lëshimi i urdhrimit sipas kësaj Rregulloreje, policia dhe personi i mbrojtur do të lidhin Marrëveshjen protokoll me shkrim (në vijim e quajtur 'Marrëveshje') në të cilën përvijohen kushtet dhe afatet e regjistrimit në programin për mbrojtje të dëshmitarëve.

4.2 Marrëveshja do t'i përmbajë këto informata:

- (a) palët e Marrëveshjes;
- (b) pëlqimin e personit të mbrojtur, në formë të deklaratës me shkrim që ai apo ajo me dashje dhe vullnetarisht regjistrohet në programin për mbrojtje të dëshmitarëve;
- (c) përshkrimin e masave mbrojtëse që do të zbatohen;
- (d) kohëzgjatjen e qëndrimit në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve;
- (e) deklaratën që të gjitha informatat e nxjerra në shesh më herët janë të vërteta dhe të sakta për atë që personi i mbrojtur dhe që ai apo ajo është i/e vetëdijshëm/e që Marrëveshja mund të marrë fund nëse ipet ndonjë informatë e pavërtetë gjatë procedimeve, apo në rast të fshehjes së qëllimshme të informatave relevante nga autoritetet;
- (f) obligimet e personit të mbrojtur janë me sa vijon:
  - 1) të japë dëshminë e plotë në cilëndo fazë të procedimeve penale, në përputhje me ligjin e zbatueshëm, pa rezerva apo kushte, në lidhje me të gjitha faktet, ngjarjet dhe rrethanat e rastit, për të cilat personi i mbrojtur është në dijeni, apo për ndonjë rast të lidhur me të;
  - 2) të përgjigjet qartë dhe saktë në të gjitha pyetjet e bëra atij apo asaj gjatë procedimeve nga autoritetet gjyqësore apo policia;
  - 3) të pranojë dhe të respektojë kushtet e regjistrimit në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve;
  - 4) të kuptojë në tërësi natyrën e informatave konfidenciale dhe nën asnjë rrethanë, të mos zbulojë çfarëdo informate sa u përket masave mbrojtëse të urdhëruara nga gjyqtari apo paneli i gjyqtarëve;
  - 5) të shmangë cilindo veprim apo mosveprim që mund të vë në rrezik integritetin dhe efikasitetin e programit për mbrojtje të dëshmitarëve;

- 6) të veprojnë në përputhje me udhëzimet e Njesisë mbrojtëse dhe të marrë pjesë aktive në ekzekutimin e masave mbrojtëse;
- 7) të informojë pa vonesë Njësine mbrojtëse lidhur me të gjitha rrethanat e ndryshuara që mund të kenë ndikim në programin e mbrojtjes;
- 8) t'i raportojë të dhënat e tij financiare, transaksionet ligjore, asetet, detyrimet dhe obligimet tjera, para regjistrimit në program;
- 9) të mbetet përgjegjës për të gjitha obligimet financiare të shkaktuara para dhe gjatë regjistrimit të tij apo saj në programin për mbrojtje të dëshmitarëve; dhe
- 10) t'i nënshtrohet ekzaminimit mjekësor.

(g) Obligimet e njesisë mbrojtëse janë me sa vijon:

- 1) Të ekzekutojnë masat mbrojtëse të parashtruara në urdhrin e lëshuar sipas kësaj Rregulloreje, vetëm me kufizime të domosdoshme të të drejtave dhe lirisë së personit të mbrojtur;
- 2) T'i ofrojnë personit të mbrojtur asistencën e nevojshme mjekësore e ligjore gjatë kohëzgjatjes së qëndrimit të tij apo saj në programin për mbrojtje të dëshmitarëve; dhe
- 3) Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së personit të mbrojtur, ashtu si kërkohet kjo me ligj.

(h) Bazat në të cilat regjistrimi në programin për mbrojtje të dëshmitarëve mund të pezullohet apo të përfundohet;

(i) Data, vendi dhe nënshkrimi i palëve; dhe

(j) Në rast se personi i mbrojtur është i mitur, prindi apo kujdestari ligjor i emëruar nga gjykata do të nënshkruajë marrëveshjen, duke marrë parasysh interesin më të mirë të të miturit si dhe zotësinë ligjore, ashtu si parashihet kjo me ligj.

#### Neni 6

#### Dhënia fund e regjistrimit në programin për mbrojtje të dëshmitarëve

Regjistrimi në programin për mbrojtje të dëshmitarëve mund të marrë fund nën këto rrethana:



- (a) Skadimi i Marrëveshjes me të cilën rregullohet regjistrimi në programin për mbrojtje të dëshmitarëve;
- (b) Vdekja e personit të mbrojtur;
- (c) Me kërkesën me shkrim nga personi i mbrojtur, me të cilën kërkohet tërheqja nga regjistrimi në programin për mbrojtje të dëshmitarëve;
- (d) Nëse personi i mbrojtur qëllimisht bën deklaratë të rrejshme në cilëndo prej procedimeve apo Marrëveshjes apo qëllimisht ka fshehur informata relevante thelbësore për rastin;
- (e) Nëse personi i mbrojtur nuk përmbushë ndonjë prej obligimeve sipas marrëveshjes, pa një arsye të mirë;
- (f) Me kërkesë të Kryeprokurorit apo të Njësisë Mbrojtëse, gjyqtari apo paneli i gjyqtarëve mund t'i jap fund regjistrimit në programin për mbrojtje të dëshmitarëve për personin e mbrojtur, nëse:
  - 1) Shkaku që ka justifikuar mbrojtjen nuk ekziston më;
  - 2) Gjatë programit të mbrojtjes, iniciohen procedime penale ndaj atij personi për shkak të kryerjes së veprës penale;
  - 3) Personi i mbrojtur nuk vepron në pajtim me rregullat dhe udhëzimet e nxjerra nga Njësia Mbrojtëse, apo bën shkeljen e obligimeve që vënë në rrezik ofrimin e mbrojtjes; apo
  - 4) Personi i mbrojtur refuzon të kërkojë punësim me qëllim të sigurimit të të ardhurave;
- (g) Shteti i huaj mund të kërkojë dhënien fund të mbrojtjes së siguruar për personin e transferuar në territorin e tij, nëse gjyqtari apo paneli i gjyqtarëve konstaton që niveli i kërcënimit ka pushuar së ekzistuar.

## Neni 7 Konfidencialiteti

7.1 Personi që vjen tek informatat që kanë të bëjnë me ofrimin e masave mbrojtëse për personin e mbrojtur, si pjesë e pozitës zyrtare apo punës së tij ose saj, do të ruajë konfidencialitetin e kësaj informate.

7.2 Secili individ i përshkruar në paragrafin (1) të këtij neni, që nxjerr në shesh informata lidhur me ofrimin e masave mbrojtëse për personin e mbrojtur, qoftë në mënyrë të qëllimshme apo nga pakujdesia, i nënshtrohet përgjegjësisë penale sipas Neneve 169 apo 311 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Neni 8  
Bashkëpunimi ndërkombëtar

8.1 Masa mbrojtëse e zhvendosjes së personave të mbrojtur mund të sigurohet në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare apo reciprocitetit, e nënshkruar nga organet kompetente dhe shteti i huaj. Autoriteti kompetent mund t'i parashtrojë kërkesën konfidenciale për zhvendosjen e personit të mbrojtur shtetit të huaj, përmes kanaleve diplomatike.

8.2 Kërkesa nuk do të përmbajë çfarëdo informatash që mund të zbulojnë identitetin apo vendndodhjen e përkohshme të personit të mbrojtur.

Neni 10  
Dispozitat kalimtare

Në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, Ministria e Punëve të Brendshme do të themelojë edhe formalisht njësinë mbrojtëse, në pajtim me ligjin e zbatueshëm

Neni 11  
Zbatimi

Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë Udhëzime Administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 12  
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e aprovimit dhe shpalljes së saj nga Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm.

**Vendim Nr. 2006/xx**

**Kryetari i Kuvendit**

\_\_\_\_\_  
**Z. Kolë Berisha**

SHTOJCA

2

VERSIONI B

---

## **PËR THEMELIMIN E PROGRAMIT PËR MBROJTJE TË DËSHMITARËVE**

Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet e dhëna atij me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren Nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, të ndryshuar, të Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), për Autoritetin në Administratës së Përkohshme në Kosovë, dhe Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999 mbi Ligjin e zbatueshëm në Kosovë,

Duke njohur që kërcënimi i palëve të dëmtuara, dëshmitarëve bashkëpunues dhe dëshmitarëve dëmton në masë të madhe përpjekjet për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të krimeve serioze në Kosovë, përfshirë këtu krimet e luftës, krimet ndër-etnike, terrorizmin dhe krimet e organizuara, dhe përbën pengesë serioze në vendosjen e sundimit të ligjit në Kosovë,

Marrë parasysh që Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK) ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004 dhe marrë parasysh në veçanti Kapitullin XXI: Mbrojtja e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve,

Me qëllim të themelimit të programit të mbrojtjes, për të mundësuar dhe rregulluar mbrojtjen e dëshmitarëve, dëshmitarëve bashkëpunues, dhe anëtarëve të ngushtë të familjeve të tyre,

Me anë të kësaj shpall me sa vijon:

### **Neni 1 Definicionet**

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje:

- (1) Shprehja “anëtar i familjes” nënkupton bashkëshortin/en, partnerin jashtëmartesor, lidhjen e gjakut në vijë direkte, prindin adoptues, fëmijën e birësuar, vëllain, motrën, apo prindin birësues.
- (2) Shprehja “palë e dëmtuar” nënkupton personin, të drejtat personale apo pronësore të të cilit janë shkelur apo rrezikuar nga vepra penale.
- (3) Shprehja “gjyqtar” nënkupton gjyqtarin e procedurës paraprake apo gjyqtarin drejtues.
- (4) Shprehja “polici” nënkupton Policinë Civile të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, e njohur gjithashtu si Policia Ndërkombëtare e OKB-së, dhe Shërbimin Policor të Kosovës. Do të përfshijë edhe policinë gjyqësore.

(5) Shprehja “person i mbrojtur” nënkupton palën e dëmtuar, dëshmitarin, dëshmitarin bashkëpunues apo anëtarin e familjes që është i kërcënuar dhe është urdhëruar të vendoset në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, në bazë të frikës së bazuar të rrezikut për jetën e tij apo saj, shëndetin fizik dhe mendor apo pronën, si pasojë e pritur e dëshmimit të tij apo saj gjatë ekzaminimit apo deponimit të dëshmisë në cilëndo fazë të procedimeve penale, me nënshkrimin e marrëveshjes protokoll me njësinë policore që bën mbrojtjen.

(6) Shprehja “program për mbrojtje të dëshmitarëve” nënkupton programin ekskluziv që operohet nga policia për implementimin dhe ekzekutimin e masave mbrojtëse të urdhëruara nga gjykata, në mbrojtje të jetës, shëndetit, lirisë dhe pronës së palës së dëmtuar, apo dëshmitarit dhe anëtarit të familjes, gjatë dhe pas procedurës penale.

(7) Shprehja “njësi mbrojtëse” nënkupton njësinë e specializuar në kuadër të policisë me përgjegjësi për rekomandimin dhe implementimin e masave mbrojtëse, dhe për operimin e programit për mbrojtje të dëshmitarëve.

(8) Shprehja “masë mbrojtëse” nënkupton masën e urdhëruar nga gjykata me qëllim të mbrojtjes së palës së dëmtuar, dëshmitarit, apo anëtarit të familjes, gjatë dhe pas procedurës penale, ashtu si parashihet me ligjin e zbatueshëm.

(9) Shprehja “rrezik serioz” nënkupton frikën e përligjur nga rreziku për jetën, shëndetin fizik apo mendor të palës së dëmtuar, dëshmitarit apo anëtarit të familjes së palës së dëmtuar apo të dëshmitarit, si një pasojë e pritur nga dëshmimi i palës së dëmtuar apo dëshmitarit gjatë ekzaminimit apo deponimit të dëshmisë në gjykatë, apo gjatë një hetimi.

(10) Shprehja ‘marrëveshje protokoll’ nënkupton marrëveshjen me shkrim, të nënshkruar nga njësia mbrojtëse e policisë dhe nga personi i mbrojtur, që rregullon ofrimin e mbrojtjes personale gjatë kohëzgjatjes së qëndrimit në programin për mbrojtje të dëshmitarëve.

(11) Shprehja “sekret zyrtar” nënkupton informatat apo dokumentet e shpallura me ligj, dispozita të tjera, apo me vendim të autoritetit kompetent të nxjerrë në bazë të ligjit, si sekret zyrtar dhe nxjerrja në shesh e të cilave ka shkaktuar apo mund të shkaktojë pasoja të dëmshme, në përputhje me Nenin 347 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

## Neni 2 Shtrirja e Rregullores

(1) Kjo rregullore përcakton procedurat me të cilat rregullohet urdhri për regjistrimin e një personi të mbrojtur në programin për mbrojtje të dëshmitarëve, gjatë dhe pas procedurës penale, dhe do të zbatohet vetëm nëse ekziston një apo më shumë nga veprat penale në vijim:

- (a) Veprat penale kundër Kosovës dhe banorëve të saj;
- (b) Veprat penale kundër së drejtës ndërkombëtare;
- (c) Veprat penale të kryera nga grupi i organizuar kriminal; dhe
- (d) Veprat penale të dënueshme me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) apo më shumë vitesh.

### Neni 3 Komisioni

(1) Do të themelohet një Komision, si bord i tre (3) anëtarëve, i përbërë nga një person prej secilit nga trupat nominues në vijim: Gjykata Supreme e Kosovës, Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës dhe Shërbimi Policor i Kosovës.

(2) Drejtuesi i secilit trup nominues do të caktojë një person nga ai trup si anëtar të Komisionit dhe një zëvendës për të vepruar në mungesë të atij anëtari. Secili anëtar dhe zëvendës mund të mbajnë pozitën në Komision për një mandat maksimal prej pesë (5) vitesh. Secili anëtar i Komisionit apo zëvendësi i tij/saj, mund të riemërohen pas skadimit të mandatit.

(3) Drejtuesi i secilit trup nominues apo Komisioni mund t'i jap fund pozitës së anëtarit të Komisionit apo zëvendësit të tij/saj të caktuar nga ai trup, për cilëndo nga shkaqet në vijim:

- (a) Përfundimi i shërbimit në trupin nominues;
- (b) Për arsye të mira, me kërkesë të anëtarit të Komisionit apo zëvendësit të tij/saj;
- (c) Shkelja e rregullave interne të procedurës së Komisionit; apo
- (d) Me nisjen e veprimit disiplinor në kuadër të trupit nominues.

(4) Komisioni miraton rregullat interne të procedurës, me të cilat rregullohet puna e tij.

(5) I caktuari i Shërbimit Policor të Kosovës do të jetë Kryesues i Komisionit.

(6) Anëtarët e Komisionit mund të diskualifikohen në përputhje me standardet e theksuara në Kapitullin III të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës për diskualifikim të gjyqtarëve. Kryesuesi i Komisionit do të vendosë rreth kërkesave për diskualifikim të anëtarëve të Komisionit, në pajtim me këto standarde. Drejtori i Shërbimit Policor të Kosovës do të vendosë rreth kërkesave për diskualifikim të Kryesuesit të Komisionit, në pajtim me këto standarde.

(7) Komisioni do të sigurojë që diskutimet dhe vendimet e tij do të mbesin sekrete dhe nuk do të bëj të ditura hollësitë e veprimeve të tij.

(8) Komisioni do të përcaktojë nëse dobia për procedimet penale nga paraqitja e dëshmisë së personit të mbrojtur, peshon më tepër se kostoja financiare e vendosjes së personit të mbrojtur në programin për mbrojtje të dëshmitarëve.

#### Neni 4

#### Kërkesa për regjistrim dhe standardet për praninë në Programin për mbrojtje të dëshmitarëve

(1) Në cilëndo fazë të procedimeve penale, prokurori publik, i pandehuri, avokati mbrojtës, apo personi i mbrojtur, mund të bëjnë kërkesë me shkrim të drejtuar gjyqtarit apo panelit të gjyqtarëve, për regjistrim në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, nën autoritetin dhe administrimin e njësisë mbrojtëse të policisë.

(2) Nëse gjyqtari apo paneli i gjyqtarëve konstaton që ekziston rreziku nga cenimi i pashmangshëm i personit të mbrojtur, gjyqtari apo paneli i gjyqtarëve mund të urdhërojë njësinë mbrojtëse që të sigurojë mbrojtje të përkohshme për atë person deri në marrjen e vendimit përfundimtar lidhur me kërkesën për regjistrim në programin për mbrojtje të dëshmitarëve.

(3) Para dhënies së urdhrimit për regjistrim në programin për mbrojtje të dëshmitarëve, gjyqtari do të mbajë dëgjimin në seancë të mbyllur, në të cilën do të ekzaminohen dëshmitari në fjalë dhe personat tjerë që konsiderohen të domosdoshëm, sikur që është policia apo personeli ushtarak që ofron sigurinë. Përveç këtyre personave, vetëm prokurori publik, personeli esencial i gjykatës dhe prokurorisë si dhe avokati mbrojtës mund të jenë të pranishëm.

(4) Personi i mbrojtur mund të regjistrohet në programin për mbrojtje të dëshmitarëve:

(a) Pas konstatimit të prokurorit që:

(i) dëshmia e dëshmitarit është relevante për çështjen materiale në shqyrtim, që në mungesë të saj mund të ndikojë në gjetjet e gjykatës; dhe

(ii) ekziston nivel i lartë i rrezikut për personin e mbrojtur; dhe

(b) Pas konstatimit të Komisionit që dobia për procedimet penale nga paraqitja e dëshmisë së personit të mbrojtur, peshon më tepër se kostoja financiare e vendosjes së personit të mbrojtur në programin për mbrojtje të dëshmitarëve, sipas Nenit 4, paragrafi 7 i Kësaj Rregulloreje.

Neni 5  
Programi për mbrojtjen e dëshmitarëve

(1) Përveç masave mbrojtëse të parashtruara në Kapitullin XXI të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, gjyqtari apo paneli i gjyqtarëve mund të urdhërojë që pala e dëmtuar apo personi i mbrojtur të regjistrohen në programin për mbrojtje të dëshmitarëve.

(2) Urdhri i lëshuar sipas këtij neni mund të sigurojë masa të tilla shtesë që janë të përshtatshme për t'u përfshirë, por që nuk kufizohen në:

- (a) mbrojtjen fizike të personit të kërcënuar;
- (b) zhvendosjen në një lokacion jashtë Kosovës;
- (c) mbrojtjen e përkohshme të identitetit, informatave dhe dokumenteve të personit të mbrojtur;
- (d) rehabilitimin social;
- (e) rikualifikimin profesional;
- (f) ndërrimin e identitetit;
- (g) mbajtjen, ndërrimin e vendit të punës dhe punësimin e përkohshëm;
- (h) asistencën ligjore;
- (i) asistencën financiare për periudhën kohore të qëndrimit në program;
- (j) mbrojtjen dhe trajtimin special në rastet ku i akuzuari është vendosur në entin korrektues, si masë sigurie para gjykimit apo kur është i dënuar me burgim; apo
- (k) masat speciale fizike e teknike të mbrojtjes në vendin ku banon personi dhe gjatë të gjitha transportimeve.

(3) Njësia mbrojtëse e policisë do të zbatojë masat e parashikuara në paragrafin (2) të këtij neni.

Neni 6  
Njësia mbrojtëse

(1) Njësia mbrojtëse do të ketë përgjegjësitë në vijim:

- (a) të dorëzojë raportin vjetor të buxhetit tek Komisionari i Policisë, lidhur me koston financiare të operimit të programit për mbrojtjen e dëshmitarëve;



- (b) të lidhë Marrëveshjen protokoll me personin e mbrojtur;
- (c) të ekzekutojë urdhrin për regjistrimin e personit të mbrojtur në programin për mbrojtje të dëshmitarëve, të lëshuar sipas kësaj Rregulloreje;
- (d) të miratojë procedurat standarde operative për zbatimin e masave mbrojtëse, me përfshirjen e procedurave për ruajtjen e të gjitha informacioneve që kanë të bëjnë me ofrimin e atyre masave;
- (e) të ruajë dokumentet origjinale të personit me identitet të maskuar apo të ndërruar; dhe;
- (f) të sigurojë praninë e personave të mbrojtur gjatë procedimeve penale.

#### Neni 7 Marrëveshja protokoll

(1) Në afat prej shtatë (7) ditësh nga lëshimi i urdhrin sipas kësaj Rregulloreje, policia dhe personi i mbrojtur do të lidhin Marrëveshjen protokoll me shkrim (në vijim e quajtur 'Marrëveshje') në të cilën përvijohen kushtet dhe afatet e regjistrimit në programin për mbrojtje të dëshmitarëve.

(2) Marrëveshja do t'i përmbajë këto informata:

- (a) palët e Marrëveshjes;
- (b) pëlqimin e personit të mbrojtur, në formë të deklaratës me shkrim që ai apo ajo me dashje dhe vullnetarisht regjistrohet në programin për mbrojtje të dëshmitarëve;
- (c) përshkrimin e masave mbrojtëse që do të zbatohen;
- (d) kohëzgjatjen e qëndrimit në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve;
- (e) deklaratën që të gjitha informatat e nxjerra në shesh më herët janë të vërteta dhe të sakta për aq sa di personi i mbrojtur dhe që ai apo ajo është i/e vetëdijshëm/e që Marrëveshja mund të marrë fund nëse ipet ndonjë informatë e pavërtetë gjatë procedimeve, apo në rast të fshehjes së qëllimshme të informatave relevante nga autoritetet;
- (f) obligimet e personit të mbrojtur janë me sa vijon:

(i) të japë dëshminë e plotë në cilëndo fazë të procedimeve penale, në përputhje me ligjin e zbatueshëm, pa rezerva apo kushte, në lidhje me të gjitha faktet, ngjarjet dhe rrethanat e rastit, për të cilat personi i mbrojtur është në dijeni, apo për ndonjë rast të lidhur me të;

(ii) të përgjigjet qartë, saktë dhe me vërtetësi në të gjitha pyetjet e bëra atij apo asaj gjatë procedimeve nga autoritetet gjyqësore apo policia;

(iii) të pranojë dhe të respektojë kushtet e regjistrimit në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve;

(iv) të mos kryej vepra penale;

(v) të kuptojë në tërësi natyrën e informatave konfidenciale dhe nën asnjë rrethanë, të mos zbulojë çfarëdo informate sa u përket masave mbrojtëse të urdhëruara në pajtim me këtë Rregullore;

(vi) të shmangë cilindo veprim apo mosveprim që mund të vë në rrezik integritetin dhe efikasitetin e programit për mbrojtje të dëshmitarëve;

(vii) të veprojë në përputhje me udhëzimet e Njesisë mbrojtëse dhe të marrë pjesë aktive në ekzekutimin e masave mbrojtëse;

(viii) të informojë pa vonesë Njësinë mbrojtëse lidhur me të gjitha rrethanat e ndryshuara që mund të kenë ndikim në programin e mbrojtjes;

(ix) t'i raportojë të dhënat e tij financiare, transaksionet ligjore, asetet, detyrimet dhe obligimet tjera, para regjistrimit në program;

(x) të mbetet përgjegjës për të gjitha obligimet financiare të shkaktuara para dhe gjatë regjistrimit të tij apo saj në programin për mbrojtje të dëshmitarëve;

(xi) t'u nënshtrohet ekzaminimeve mjekësore e psikologjike; dhe

(xii) të bëjë përpjekje të arsyeshme në kërkimin e mundësive për punësim apo aktivitet tjetër të ligjshëm për krijim të të ardhurave.

(g) Obligimet e njesisë mbrojtëse janë me sa vijon:

(i) Të ekzekutojë masat mbrojtëse të parashtruara në urdhrin e lëshuar sipas kësaj Rregulloreje, vetëm me kufizime të domosdoshme të të drejtave dhe lirisë së personit të mbrojtur;

(ii) T'i ofrojë personit të mbrojtur asistencën e nevojshme mjekësore e ligjore gjatë kohëzgjatjes së qëndrimit të tij apo saj në programin për mbrojtje të dëshmitarëve; dhe

(iii) Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së personit të mbrojtur, ashtu si kërkohet kjo me ligj.

(h) Bazat në të cilat regjistrimi në programin për mbrojtje të dëshmitarëve mund të pezullohet apo të përfundohet;

(i) Data, vendi dhe nënshkrimi i palëve; dhe

(j) Në rast se personi i mbrojtur është i mitur, prindi apo kujdestari ligjor i emëruar nga gjykata do të nënshkruajë marrëveshjen, duke marrë parasysh interesin më të mirë të të miturit si dhe zotësinë ligjore, ashtu si parashihet kjo me ligj.

#### Neni 8

Dhënia fund e regjistrimit në programin për mbrojtje të dëshmitarëve

(1) Regjistrimi në programin për mbrojtje të dëshmitarëve mund të marrë fund nën këto rrethana:

(a) Skadimi i Marrëveshjes me të cilën rregullohet regjistrimi në programin për mbrojtje të dëshmitarëve;

(b) Vdekja e personit të mbrojtur;

(c) Me kërkesën me shkrim nga personi i mbrojtur, me të cilën kërkohet tërheqja nga regjistrimi në programin për mbrojtje të dëshmitarëve;

(d) Nëse personi i mbrojtur qëllimisht bën deklaratë të rrejshme në cilëndo prej procedimeve apo Marrëveshjes apo qëllimisht ka fshehur informata relevante thelbësore për rastin;

(e) Nëse personi i mbrojtur nuk përmbushë ndonjë prej obligimeve sipas marrëveshjes, pa një arsye të mirë;

(f) Me kërkesë të Kryeprokurorit, Njësisë Mbrojtëse, apo shtetit të huaj, gjyqtari apo paneli i gjyqtarëve mund t'i jap fund regjistrimit në programin për mbrojtje të dëshmitarëve për personin e mbrojtur, nëse:

1) Shkaku që ka justifikuar mbrojtjen nuk ekziston më;

2) Gjatë programit të mbrojtjes së dëshmitarit, iniciohen procedime penale ndaj atij personi për shkak të kryerjes së veprës penale të dënueshme me burgim më të gjatë se një vit; apo

3) Personi i mbrojtur nuk vepron në pajtim me rregullat dhe udhëzimet e nxjerra nga njësia mbrojtëse, apo në ndonjë mënyrë tjetër nuk plotëson një obligim në Marrëveshje.

#### Neni 9 Konfidencialiteti

(1) Personi që vjen tek informatat që kanë të bëjnë me ofrimin e masave mbrojtëse për personin e mbrojtur, si pjesë e pozitës zyrtare apo punës së tij ose saj, do të ruajë konfidencialitetin e kësaj informate, që do të konsiderohet si sekret zyrtar.

(2) Secili individ i përkthyer në paragrafin (1) të këtij neni, që nxjerr në shesh sekretin zyrtar sipas kësaj Rregulloreje, lidhur me ofrimin e masave mbrojtëse për personin e mbrojtur, qoftë në mënyrë të qëllimshme apo nga pakujdesia, do të dënohet në përputhje me ligjin e zbatueshëm penal.

#### Neni 10 Bashkëpunimi ndërkombëtar

(1) Masa mbrojtëse e zhvendosjes së personave të mbrojtur mund të sigurohet në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare apo reciprocitetit, e nënshkruar nga organet kompetente dhe shteti i huaj. Autoriteti kompetent mund t'i parashtojë kërkesën konfidenciale për zhvendosjen e personit të mbrojtur shtetit të huaj, përmes kanaleve diplomatike.

(2) Kërkesa nuk do të përmbajë çfarëdo informatash që mund të zbulojnë identitetin apo vendndodhjen e personit të mbrojtur.

#### Neni 11 Dispozitat kalimtare

(1) Në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, Ministria e Drejtësisë do të themelojë edhe formalisht njësinë mbrojtëse, në pajtim me ligjin e zbatueshëm.

#### Neni 12 Zbatimi

(1) Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë Udhëzime Administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 13  
Hyrja në fuqi

(1) Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e aprovimit dhe shpalljes së saj nga Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm.

# SHTOJCA

3

### **Shtojca 3** **Ekspertët e Ekipit vlerësues**

**Joseph Paonessa**, Krye Inspektor, Shef i Degës në Zyrat qendrore, Programi për siguri të dëshmitarëve, Divizioni i Shërbimeve Hetuese, Shërbimi Marshal i Shteteve të Bashkuara.

Z. Paonessa ka shërbyer në Shërbimin Marshal të ShBA (USMS) që nga viti 1983. Gjatë kësaj kohe, ai ka menaxhuar një varg të gjerë të shërbimeve për siguri dhe mbrojtje të dëshmitarëve. Së fundi, ai ka drejtuar Zyrat qendrore të WITSEC, ku ka qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e operacioneve për mbrojtje të dëshmitarëve nëpër Shtetet e Bashkuara. Është pensionuar nga USMS në fund të vitit 2006, por vazhdon të punojë në këtë fushë si konsulent. Që nga viti 1998, Z. Paonessa ka udhëtuar nëpër Evropë dhe Amerikën Latine, duke mbajtur fjalime në konferenca dhe duke marrë pjesë në programet tjera për të shtyrë përpara zhvillimin, implementimin dhe administrimin e programeve efektive për mbrojtje të dëshmitarëve. Në prill 2006, Z. Paonessa ka pranuar Shpërblimin e Drejtorit të USMS për Shërbim të dalluar, si shpërblimi më i lartë që prezantohet nga USMS, për kontributet e tij për komunitetin ndërkombëtar të iniciativave për mbrojtje të dëshmitarëve.

**Eric Seidel**, Zëvendës Shef, Zyra e shantazhit, Zyra e Prokurorit të Qarkut të kontesë së Nju Jorkut, qyteti Nju Jork, shteti i Nju Jorkut. Z. Seidel ka qenë prokuror për mbi 27 vite, në zyrat lokale, shtetërore e federale. Ka shërbyer si Asistent i Prokurorit të Shteteve të Bashkuara në Distriktin Jugor të Nju Jorkut, si Zëvendës Prokuror i Përgjithshëm, me përgjegjësi mbi Task Force për Krim të organizuar për shtetin e Nju Jorkut dhe si Asistent i Prokurorit të Qarkut në Zyrën e Prokurorit të Qarkut për Distriktin e Bruklinit, ku ka qenë shef i Zyrës për Krimin e Organizuar, dhe ku është marrë me një varg të gjerë hetimesh dhe ndjekjesh penale, në lidhje me krimin e organizuar, vrasjet, terrorizmin, mashtrimet e jakës së bardhë, krimet e rrugës dhe korrupsionin publik nga zyrtarët qeveritarë të zgjedhur dhe të emëruar. Në atë cilësi, ka sponsorizuar një numër dëshmitarësh në WITSEC dhe ka hetuar e gjykuar mjaft raste duke shfrytëzuar dëshmitarët në WITSEC. Ka marrë pjesë gjithashtu në shumë konferenca ndërkombëtare, si ekspert për mbrojtje të dëshmitarëve, në Lituani, Republikën Çeke, Serbi, Kroaci dhe Poloni. Z. Seidel mban gjithashtu kursin në Krimin e Organizuar, si profesor ndihmës në Shkollën Juridike të Universitetit Fordham, në qytetin e Nju Jorkut.

**Fabio Licata**, Gjyqtar, Gjykata e Palermos, Itali. Gjyqtari Licata ka drejtuar disa gjykime të rëndësishme të krimeve të mafies, përfshirë këtu shantazhin, bashkimet kriminale, korrupsionin në kontratat publike, dhe është marrë gjerësisht me rastet të cilat kanë pasur të bëjnë me sigurinë e dëshmitarëve. Si gjyqtar i sektorit të "masave parandaluese" ("misura di prevenzione"), është marrë me shumë procedura të marrjes dhe konfiskimit të pronave të mëdha të anëtarëve të Cosa Nostra-s dhe të drejtuesve kryesorë të tyre. Si gjyqtar i dëgjimeve paraprake dhe hetimeve paraprake, është marrë me shumë procedura

rreth krimit të organizuar (mafia, narkotikët, korrupsioni, etj.), ka lëshuar shumë urdhra arresti dhe dënime të shumta ndaj anëtarëve të krimit të organizuar (veçmas asociacionet mafioze, vrasjet, pastrimi i parave, trafikimi i drogës, shantazhi, korrupsioni, etj) si dhe në rastet e dhunës dhe keqtrajtimit të grave e fëmijëve.



# SHTOJCA

4

## **Shtojca 4** **Intervistat dhe vizitat në lokacione**

### **Gjyqtarët**

Rexhep Haxhimusa, Kryetar, Gjykata Supreme e Kosovës  
Carol Peralta, Gjyqtar kryesor ndërkombëtar  
Esat Shala, Kryetar, Gjykata e Qarkut, Pejë

### **Prokurorët**

Ismet Kabashi, Zëvendës i Prokurorit të Përgjithshëm Publik të Kosovës  
Besim Kelmendi, Prokuror, Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës  
Flamur Kelmendi, Krye-prokuror i Qarkut, Pejë  
Osman Kryeziu, Krye-prokuror i Qarkut, Prishtinë

### **Policia**

#### *Shërbimi Policor i Kosovës*

Sheremet Ahmeti, Zëvendës Komisar i Policisë, ShPK  
Nazmija Bashovic, Drejtor, Njësia e Inteligjencës Kriminale, ShPK  
Fatos Haziri, Drejtor, Drejtoria e Krimin të Organizuar, ShPK  
Rrahman Sylejmani, Asistent i Zëvendës Komisarit të Policisë

#### *Policia e UNMIK-ut*

Scott Anderson, Zëvendës Komisar i Policisë  
Steven Curtis, ish Komisionar i Policisë  
Lars Finstad, Drejtor i Njësive të Specializuara  
Reshat Maliqi, Asistent i Zëvendës Komisarit të Policisë për Operacionet  
David Morris, CIVPOL Njësia e Inteligjencës Kriminale

#### *Njësia për mbrojtje të dëshmitarëve*

Alice Berzoini, Drejtues në ardhje, Njësia për mbrojtje të dëshmitarëve  
Trent Humphrey, Drejtues në largim, Njësia për mbrojtje të dëshmitarëve

### **UNMIK/ DD**

#### *Departamenti i Drejtësisë /Ligjor*

Alexander Borg-Olivier, Këshilltar ligjor në UNMIK  
Annunziata Ciaravolo, ish Zëvendës Drejtor, Krye-prokuror ndërkombëtar  
Steven Dietrich, Zëvendës Shef, Divizioni i politikave ligjore, UNMIK

William Irvine, Drejtues, Divizioni i Menaxhimit Penal  
Albert Moskowitz, ish Drejtor, DD  
Ralph Stephani, Drejtues, Departamenti i Krimin të Organizuar

## **Të tjerë**

Komisioni i Kuvendit për çështjet gjyqësore, legislative dhe të kornizës kushtetuese

Blerim Kuçi, Ministër i Punëve të Brendshme  
Theo Kuys, Zëvendës Drejtor i Burgut të Dubravës  
Valon Maxharraj, Qendra e Paraburgimit, Lipjan  
Jonuz Salihaj, Ministër i Drejtësisë

## **Vizitat në lokacione**

Burgu i Dubravës  
Qendra e Paraburgimit në Lipjan

# SHTOJCA

5

# KONVENTA E BASHKËPUNIMIT POLICOR PËR EVROPËN JUGLINDORE

## **Preambula**

*Republika e Shqipërisë, Bosnjës e Hercegovinës, Republika e Maqedonisë, Republika e Moldavisë, Rumania dhe Unioni Shtetëror Serbi e Mal i Zi*

*Tutje të quajtura "Palët kontraktuese",*

*Me dëshirën për të bashkëpunuar në mënyrë që të ndiqen interesat e përbashkëta të sigurisë,*

*Të vendosur që të luftojnë në mënyrë efektive kërcënimet ndër-kufitare ndaj rendit dhe sigurisë publike dhe krimin ndërkombëtar, duke hyrë në partneritetin e sigurisë,*

*Me synimin për të intensifikuar dhe rritur më tej bashkëpunimin policor,*

*Të vendosura për të forcuar më tej asistencën e ndërsjellë në çështjet policore,*

*Pajtohen për sa vijon:*

## **Neni 1**

### **Objektivi i Konventës**

Palët kontraktuese do të përforcojnë bashkëpunimin e tyre në drejtim të luftimit të kërcënimeve ndaj sigurisë dhe/ose rendit publik si dhe në drejtim të parandalimit, zbulimit dhe hetimit policor të veprave penale. Kjo bëhet në bazë të ligjit vendor për veq në rastet kur ndryshe parashihet me ligj.

## **Neni 2**

### **Definicionet**

Për qëllim të kësaj Konvente

- a) "Autoritetet për zbatim të ligjit", nënkupton autoritetet të cilat në pajtim me ligjin vendor të Palëve Kontraktuese kanë kompetencën e nevojshme për të zbatuar dispozitën e kësaj Konvente;
- b) "Zyrtarët" nënkupton cilido individ i emëruar nga autoritetet për zbatim të ligjit;
- c) "Kufijtë" nënkupton kufijtë tokësor të Palëve Kontraktuese, kufijtë detar, të lumenjve, aeroportet dhe portet e tyre detare të definuar nga ligji vendor dhe të pranuar ndërkombëtarisht;

- d) "Shteti i tretë" nënkupton cilindo shtet tjetër përpos Palëve Kontraktuese;
  - e) "Leja rezidenciale" nënkupton autorizim të çfarëdo lloji të lëshuar nga Pala Kontraktuese i cili siguron të drejtë banimi brenda territorit të vet. Ky definicion ka për qëllim të nxitoj dhe të qoj përpara bashkëpunimin në mes të Palëve Kontraktuese, veçanërisht duke ofruar ndihmë;
    - a. në formë të shkëmbimit të informatave për qëllime të kësaj Konvente
    - b. duke ekzekutuar kërkesat për ndihmë policore të ndërsjellë në çështjet penale
    - c. me detyrat e kryera nga ana e autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrje të kufijve
- (3) Zyrtarët ndërlidhës do të kenë për detyrë të ofrojnë këshilla dhe asistencë. Ata nuk do të jenë të autorizuar të ndërmarrin veprime policore të pavarura. Ata do të japin informata dhe do t'i ushtrojnë detyrat e tyre në përputhje me udhëzimet e marra nga Pala Kontraktuese deleguese dhe nga Pala Kontraktuese në të cilën ata janë deleguar.
- (4) Palët Kontraktuese mund të pajtohen përmes një kornize bilaterale ose multilaterale që zyrtarët ndërlidhës nga Palët Kontraktuese që delegohen në shtetet e treta gjithashtu do të përfaqësojnë interesat e një apo më shumë Palëve Kontraktuese. Sipas marrëveshjeve të tilla, zyrtarët ndërlidhës të deleguar në shtete të treta do t'i japin informata Palëve Kontraktuese kur kjo kërkohet nga ata apo me vetë iniciativën e tyre dhe, brenda kufijve të autoritetit të tyre do të kryejnë detyra në të mirë të Palëve të tilla. Palët Kontraktuese do ta informojnë njëra tjetrën në lidhje me delegimin e zyrtarëve ndërlidhës në shtetet e treta

## Neni 10

### Mbrojtja e dëshmitarëve

- (1) Autoritetet për zbatim të ligjit të Palëve Kontraktuese, të caktuara për mbrojtjen e dëshmitarëve, do të bashkëpunojnë drejtpërdrejtë në fushën e programeve për mbrojtje të dëshmitarëve.
- (2) Bashkëpunimi do të përfshijë në veçanti këmbimin e informatave, asistencën sa i përket logjistikës, dhe marrjen në dorëzim të personave që do të mbrohen.
- (3) Një Marrëveshje do të nënshkruhet për secilin rast të veçantë të marrjes në dorëzim të personave që do të mbrohen, me qëllim të rregullimit të të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella.

- (4) Personi që do të mbrohet duhet të jetë vënë nën programin e mbrojtjes së dëshmitarëve të Palës Kontraktuese që bën kërkesën. Personi që do të mbrohet nuk do të përfshihet në programin për mbrojtje të dëshmitarëve të Palës kontraktuese të cilës i bëhet kërkesa. Në ndërmarrjen e masave mbështetëse në lidhje me mbrojtjen e këtyre personave, do të zbatohet legjislacioni nacional i Palës Kontraktuese të cilës i bëhet kërkesa, në përputhje me rrethanat.
- (5) Në parim, Pala Kontraktuese që bën kërkesën do të bartë koston e jetesës për personat që do të vihen nën mbrojtje. Pala Kontraktuese të cilës i bëhet kërkesa do të bartë shpenzimet për personelin dhe resurset materiale për mbrojtjen e këtyre personave.
- (6) Për shkaqe serioze dhe pasi të jetë njoftuar siç duhet Pala Kontraktuese që bën kërkesën, Pala Kontraktuese të cilës i bëhet kërkesa mund të ndërpresë masat mbështetëse. Në këtë rast, Pala Kontraktuese që bën kërkesën do të rimarrë personin në fjalë.

# SHTOJCA

6



## Grafiku krahasues për Programet e mbrojtjes së dëshmitarëve<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Përgatitur nga Zyra e Këshilltarit ligjor rezident, Ambasada e ShBA, Beograd

Vendi	Viti i dekretimit	Përshtatshmëria	Kush bën kërkesën?	Kush vendosë?	Zhvendosja brenda vendit	Zhvendosja ndërkombëtare apo këmbimi i dëshmitarëve
<u>Shqipëri</u>	2004	Dëshmitarët dhe familja (Neni 8) Bashkëpunëtorët e Drejtësisë dhe familja (Neni 9)	Prokurori (Neni 5 §A)	Komisioni për vlerësimin e masave speciale për mbrojtje të dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë (Neni 6)	Po (Neni 10)	Të dyja këto janë të parashikuara shprehimisht si pjesë e marrëveshjeve ndërkombëtare (Neni 22)
<u>Australi</u>	1994	Dëshmitarët dhe familja, Bashkëpunëtorët e Drejtësisë dhe familja (Neni 4): <i>Shih definicionin ligjor të "dëshmitari"</i> (Neni 3)	Komisionarët e Policisë së Shtetit, Kryeshefi i Komisionit Australian të Krimeve, trupat tjerë të aprovuar nga Ministri: <i>Shih definicionin ligjor të "autoritetit të aprovuar"</i> (Neni 3)	Komisionari i Policisë Federale të Australisë (Neni 8)	Po (Neni 13)	Është i parashikuar pranimi i dëshmitarëve të huaj (Neni 10)
<u>Austri</u>	1997	Individët që janë në rrezik për shtak se ofrojnë shenja apo informata të dobishme dhe ndihmojnë në zgjidhjen e krimeve që lidhen me krimin e organizuar, krimet kundër shtetit, krimet që lidhen me drogat dhe krimet kapitale jashtëzakonisht serioze (Neni 41A i Kodit Penal)	Nuk përmendet në ligj	Departamenti 5 (BK/5), Nën-Departamenti 5.4 (Zyra për mbrojtje të dëshmitarëve) dhe Shërbimi i Inteljencës Kriminale (bundeskriminalamt)	Nuk përmendet në ligj	Po
<u>Bosnië &amp; Hercegovinë</u>	2004	Dëshmitarët dhe familja (Neni 2)	Nuk përmendet në ligj	Departamenti për mbrojtje të dëshmitarëve në kuadër të Agjencisë Shtetërore të Hetimeve dhe Mbrojtjes (SIPA) (Neni 3)	Nuk përmendet në ligj	Është i parashikuar pranimi i dëshmitarëve të huaj (Neni 3)
<u>Bahame</u>	2005	Pjesëmarrësit me informata për veprat e paraqitura në Pasqyrën Dy (apo çështjet tjera për të cilat Ministri, pas konsultimeve me Prokurorin e Përgjithshëm dhe me Komisionarin e Policisë i konsideron se shirojnë nevojën për shfrytëzim të Programit) (Pjesa III, Neni 12)	Prokurori i përgjithshëm (pas konsultimit me Drejtorin e Prokurorive Publike dhe me Komisionarin e Policisë) (Pjesa III, Neni 11)	Qendra Administrative (Pjesa III, Neni 8, §1)	Nuk përmendet në ligj	Janë parashikuar marrëveshjet apo memorandumet e mirëkuptimit (Pjesa III, Neni 9 §2)

<u>Bullgari</u>	2005	Pjesëmarrësit (psh. dëshmitarët, të dyshuarit, të pandehurit ), personat e dënuar, dhe personat pasardhës apo paraardhës nga të lartë përmendurit, apo ata në lidhje vecmas të afërt me ta. (Neni 3)	Personat e rezikuar, organet hetuese, prokurorët mbikëqyrës, apo drejtorët e qendrave të paraburgimit <b>Aplikojnë</b> tek Prokurori i Qarkut dhe Gjyqtari raportues i fazës së gjykimit, që bëjnë shqyrtimin e kërkesës para se të kenë vendosur nëse do ta dorëzojnë në CPEP (Neni 15, par 1/2)	Këshilli për mbrojtjen e personave të rezikuar (Neni 13)	Po (Neni 6)	Janë të parashikuara pranimit i dëshmitarëve të huaj / kërkesat për qeveritë e huaja (Neni 27)
<u>Kanada</u>	1996	Dëshmitarët dhe ata që për shkak të raportit me dëshmitarin mund të kenë githashtu nevojë për mbrojtje (Neni 2)	Agjencia për zbatim të ligjit apo Gjykata penale ndërkombëtare / Tribunalet (Neni 5)	Komisionari i Forcës (Neni 5)	Nuk përmendet në ligj	Është parashikuar marrëveshja reciproke (Neni 14, par 2)
<u>Kroaci</u>	2004	Dëshmitarët dhe "personat e afërt" (Neni 36)	Prokurori i përgjithshëm shtetëror (Neni 9)	Bordi (ashtu si parashihet nga Ligji për mbrojtje të dëshmitarëve) (Neni 8)	Po (Neni 15)	Është parashikuar pranimit i / kërkesat për dërgim të dëshmitarëve (Neni 42)
<u>Republika Çeke</u>	2001	Dëshmitarët, ekspertët, përktlyesit, avokatët, apo ata që janë në lidhje të afërta me ta (Neni 2)	Policia, Gjyqtarët, Prokurorët Shtetëror (Neni 4)	Ministri i Brendshëm (Neni 4)	Po (Neni 3)	Është parashikuar bashkëpunimi me marrëveshje (Neni 21)
<u>Gjermani</u>	2001	Dëshmitarët, familja apo personat e afërt me ta (Neni 1)	Nuk përmendet në ligj	Njësitë për mbrojtje të dëshmitarëve (Neni 2)	Nuk përmendet në ligj	Nuk përmendet në ligj
<u>Itali</u>	1991	Dëshmitarët, bashkëpunëtorët e drejtësisë, familja apo personat e afërt (Kapitulli II, Neni 9 [2])	Prokurori Publik, apo në disa raste zëvendës prokurori publik i qarkut Anti-Mafia, apo Shefi i Policisë - Drejtori Gjeneral i Departamentit të Sigurisë Publike (Kapitulli II, Neni 11 [1])	Komisioni qendror (Kapitulli II, Neni 11 [1])	Po (Kapitulli II, Neni 13 [4])	Nuk përmendet në ligj
<u>Latvi</u>	2005	(1) Dëshmitarët, viktimat (2) personat rreziku ndaj të cilëve mund të ndikojë në personin që jep dëshminë (3) personat jo-dëshmues që marrin pjesë në hetimin / gjykimin e krimit serioz (Neni 4)	<b>Pala dëshmuese:</b> Ushtruesi i procedurave <b>Personat tjerë:</b> vetë-kërkesa (Neni 4)	<b>Pala dëshmuese:</b> Prokurori i përgjithshëm apo Gjykata <b>Personat tjerë:</b> drejtuesi i Institucionit të mbrojtjes speciale (Neni 4)	Po (Neni 16)	Është parashikuar bashkëpunimi me marrëveshje (Neni 16, 21)

<u>Lituani</u>	1997	(1) Pjesëmarrësit e aktivitetit klandestin (2) Pjesëmarrësit e procedimit penal- dëshmitarët, viktimat, ekspertët, mbrojtësit, të dyshuarit, të akuzuarit, të pandehurit, të dënuarit (3) Zyrtarët e administrimit të ligjit dhe drejtësisë- gjyqtarët, prokurorët, përmbaruesit e gjykatës, zyrtarët e martes në pyetje, hetuesit (Neni 3)	Individi që kërkon mbrojtje (Neni 12)	Zbatimi i ligjit dhe administrimi i drejtësisë : Prokurori i përgjithshëm, Krye Prokurori rajonal apo Krye Prokurori i Zonës Dëshmitarët, viktimat, ekspertët, të dyshuarit, të akuzuarit, të dënuarit: Zyrtarët e lartpërmendur plus: Shefi i Departamentit të Policisë të Ministrisë së Brendshme dhe Shefi i Komësarariatit të Policisë së Qytetit (Neni 12)	Po (Neni 5)	Nuk përmendet në ligji
<u>Magedoni</u>	2005	Dëshmitarët (duke përfshirë viktimat), bashkëpunëtorët e drejtësisë, dhe personat e afërt me ta (Neni 1)	Ministria e Brendshme, prokurori publik kompetent apo gjyqtari aplikon tek Prokurori publik, që bën dorëzimin e propozimit (Neni 15)	Këshilli për mbrojtje të dëshmitarëve (Neni 10)	Po (Neni 26) (Neni 30) (Neni 40)	Është parashikuar bashkëpunimi me marrëveshje (Neni 30) (Neni 40)
<u>Mali i Zi</u>	2005	Dëshmitarët (cilido person me informata jetike për vërtetimin e veprës penale, pa marrë parasysh statusin në procedurën penale) dhe personat e afërt me ta (Neni 1) (Neni 4)	Dëshmitari, prokurori shtetëror, gjyqtari i rasit, Drejtori i Institutit për zbatim të sanksioneve penale apo shefi i Administratës së policisë kriminale <b>Aplikojnë tek</b> Krye Prokurori Shtetëror që bën dorëzimin e propozimit (Neni 14)	Komisioni për zbatimin e programit për mbrojtje të dëshmitarëve (Neni 6)	Po (Neni 26) (Neni 29) (Neni 44)	Është parashikuar zhvendosja dhe bashkëpunimi ndërkombëtar (Neni 29) (Neni 44)
<u>Poloni</u>	1997	Dëshmitari dhe personi më i afërt me të (Neni 14)	Individi që kërkon mbrojtje (Neni 17)	Prokurori Publik (Neni 17)	Po (Neni 14)	Është parashikuar bashkëpunimi me marrëveshje ndërkombëtare (Neni 15)
<u>Rumani</u>	2002	Dëshmitarët, familja, personat e afërt me ta (Neni 9)	Organi hetues penal dhe prokurori (Neni 5)	Prokurori apo Gjykatata (Neni 7)	Po (Neni 12)	Bashkëpunimi ndërkombëtar është i autorizuar (Neni 24)
<u>Rusi</u>	2005	Viktimat, dëshmitarët, prokurorët privat, të dyshuarit, ekspertët, paditësit civil dhe të pandehurit, përfaqësuesit ligjor, dëshmitarët okular, të afërmit e ngushtë dhe personat në lidhje me ta (Neni 2)	Individi që kërkon mbrojtjen (Neni 16)	Gjyqtari, Prokurori, shefi i agjencisë hetuese apo hetuesi që merret me krimin në fjalë (Neni 3)	Po (Neni 6)	Nuk përmendet shprehimisht (Neni 5)

<b>Serbi</b>	<b>2006</b>	Pjesëmarrësit e procedimeve penale dhe personat e afërt me ta (Neni 5)	Prokurori publik, gjyqtari hetues apo presidenti i panelit të gjyqtarëve (Neni 25)	Komisioni për Implementim të Programit të mbrojtjes (Neni 7)	Po (Neni 14)	Është parashikuar bashkëpunimi ndërkombëtar (Neni 39)
<b>Republika e Sllovakisë</b>	<b>1998</b>	Dëshmitarët e rezikuar, dëshmitarët e mbrojtur dhe personat e afërt me ta (Neni 1)	Hetuesi penal apo prokurori gjatë procedimeve penale, dhe gjyqtari gjatë procedimeve gjyqësore (Neni 3)	Komisioni (Neni 4)	Po (Neni 7, Par 8)	Është parashikuar bashkëpunimi ndërkombëtar (Sec 11)
<b>Shtetet e Bashkuara</b>	<b>2000</b>	Dëshmitarët, dëshmitarët potencial, familja apo personat e afërt (Titulli 18, Pika II, Kapitulli 224, Neni 3521, par [a]1)	Ndihmës Prokurorët e Shteteve të Bashkuara (Prokurorët Federal)	Prokurori i përgjithshëm - që poashtu mund ta delegojë këtë përgjegjësi (... Neni 3521, par [a]1)	Po (... Neni 3521, par [a]1)	Nuk përmendet shprehimisht në ligj

# SHTOJCA

7

**Drafti i shtesave në dispozitat relevante të Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal të Kosovës për lejimin e marrëveshjes së negociuar mbi fajësinë<sup>1</sup>**

**I. Draft neni mbi Marrëveshjet e negociuara mbi fajësinë në Kodin e Procedurës Penale.** (Kjo duhet ti shtohet Kodit si nën – kapitull dhe duhet të vendoset në mes të nën – kapitujve “Ngritja e aktakuzës” dhe “Konfirmimi i aktakuzës” sepse kjo do të ishte koha më e mirë gjatë procedurës për negociimin e marrëveshjes mbi fajësinë)

**Marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë**

**Neni \_\_\_**

(1) Në çdo kohë pas ngritjes së aktakuzës dhe para përfundimit të shqyrtimit kryesor, prokurori publik dhe mbrojtësi, mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes me shkrim mbi pranimin e fajësisë në bazë të cilës i akuzuari pranon fajësinë në shkëmbim për:

- a) pajtimin e prokurorit publik të tërheq disa pika të aktakuzës;
- b) pajtimin e prokurorit publik të rekomandojë gjykatës dënim më të butë, përfshirë atë që është nën minimumin e parashikuar me ligj; ose
- c) konsiderime tjera në interes të drejtësisë, si është lirimi nga dënimi i parashikuar me nenin 303 të Kodit.

(2) Në rastet kur i akuzuari dëshiron të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, mbrojtësi i të akuzuarit, ose i akuzuari nëse nuk përfaqësohet nga mbrojtësi, do të kërkojë nga prokurori një takim preliminar për të filluar negociimin për marrëveshje mbi pranimin e fajësisë. Në të gjitha negociatat e tilla i pandehuri do të jetë i përfaqësuar nga mbrojtësi, në pajtim me nenin 73.1.5 përveç në rastet kur gjykata lejon që procedura të vazhdojë pa mbrojtës.

(3) Pas pranimit të kërkesës për takim preliminar, prokurori do ta informojë kryeprokurorin e zyrës së tij, i cili do të jep autorizim me shkrim për mbajtjen e takimit (eve) për diskutimet mbi pranimin e fajësisë, në të cilin deklaratave të akuzuarit do ti jepet imunitet i kufizuar si parashihet me paragrafin 5 më poshtë. Të gjitha marrëveshjet mbi fajësinë duhet të jenë në formë të shkruar dhe të pranuar nga kryeprokurori i zyrës së prokurorisë publike përkatëse para se formalisht ti ofrohen të akuzuarit.

(4) Marrëveshja me shkrim mbi pranimin e fajësisë mund të përfshijë dispozitën që prokurori në pajtim me nenin 299 të kërkojë urdhër që shpall të akuzuarin si “dëshmitar bashkëpunues” të definuar në nenin 298 të Kodit. Nëse i akuzuari i tillë jep asistencë, si dëshmitar bashkëpunues, prokurorit publik ose pajtohet të bëhet informator i policisë, prokurori publik do ti rekomandojë gjykatës një dënim më të butë i cili do të reflektojë nivelin e

---

<sup>1</sup> Ky nen është përpiluar nga Gjyqtari I nderuar John R. Tunheim, dhe përfshin komentet e USDOJ/OPDAT dhe grupit të nivelit të lartë të gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve mbrojtës Kosovar të cilët ishin pjesëmarrës në diskutimet lidhur me draftin e mëhershëm më 22 Mars 2007.

ndihmës dhe bashkëpunimit të dhënë nga i akuzuari, duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale.

(5) I akuzuari dhe mbrojtësi i tij, duhet të jenë prezent gjatë takimeve mbi negocimin e pranimit të fajësisë dhe duhet të pajtohen me kushtet e marrëveshjes me shkrim mbi pranim të fajësisë para se ajo mund ti prezantohet gjykatës. Prokurori publik do të informojë palën e dëmtuar me marrëveshjen e arritur pasi që ajo të arrijë formën përfundimtare. Kur pala e dëmtuar ka kërkesë pronësoro juridike që rrjedh nga veprimi penal që akuzohet, marrëveshja mbi fajësinë duhet ta adresojë kërkesën e palës së dëmtuar, dhe prokurori duhet të njoftojë palën se i pandehuri kërkon të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë. Palës së dëmtuar duhet ti jepet rasti që të deklarohet para gjykatës mbi kërkesën pronësoro juridike para se gjykata ta pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

(6) Gjykata nuk do të merr pjesë ne negocimin e pranimit të fajësisë, por mund të caktojë afate të arsyeshme kohore, jo më të gjatë se tre (3) muaj, për përfundimin e negociatave në mënyrë që të pengohen vonesat.

(7) Në çdo kohë para se gjykata të pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, prokurori publik ose i akuzuari mund të refuzojnë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe kryetari i kolegjit do të caktoj seancën për shqyrtim kryesor siç parashihet me nenin \_\_\_ e këtij ligji. Në qoftë se prokurori publik dhe mbrojtësi apo i akuzuari dështojnë të arrijnë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, ose nëse marrëveshja nuk pranohet nga gjykata, deklaratat e të akuzuarit të dhëna në takimin paraprak të mbajtur për të negociuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë (siç është paraparë më lartë me paragrafin 2 dhe 3) do të jenë të papranueshme si dëshmi gjatë shqyrtimit kryesor ose ndonjë procedure tjetër, përveç për rastet e kundërshtimit të deklaratës së të pandehurit.

(8) Marrëveshja me shkrim mbi pranimin e fajësisë duhet të përmbajë të gjitha kushtet e marrëveshjes, duhet të jetë e nënshkruar nga kryeprokurori i zyrës përkatëse, mbrojtësi dhe i akuzuari, dhe është detyruese për të gjitha palët nënshkruese. Marrëveshja mbi fajësinë duhet së paku të përfshijë:

- a) Pikat e aktakuzës për të cilat i akuzuari pranon fajësinë;
- b) A pranon i akuzuari të bashkëpunojë;
- c) Te drejtat nga të cilat hiqet dorë;
- d) Përgjegjësia e të akuzuarit për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar dhe konfiskimi i të gjitha të mirave materiale në pajtim më nenet 489 – 99 të këtij ligji.

(8.1) Marrëveshja me shkrim po ashtu mund të përfshijë dispozitën në të cilën palët pajtohen për kufijtë e dënimit që do të propozohen nga ana e prokurorit nëse i akuzuari bashkëpunon substancialisht, dhe nëse gjykata shqipton dënim i cili dëmton një palë, pala do të ketë të drejtë ankese ndaj dënimit.

(9) Marrëveshja me shkrim duhet të prezantohet ne gjykatë në seance të hapur publike, përveç ne rastet e përshkuara në paragrafin 11.



(10) Gjykata zyrtarisht mund ta pranoj apo refuzoj marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në përputhje me faktorët nga paragrafi 12, të cilët duhen të merren parasysh. Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë do të hyjë në fuqi vetëm pasi që të evidentohet në procesverbal se është pranuar zyrtarisht nga gjykata.

(11) Me kërkesën e cilëso palë, gjykata mund të urdhëroj seancën dëgjimore për të shqyrtuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të jetë jopublike, dhe ajo mund të urdhëroj që marrëveshja në formë të shkruar mbi pranimin e fajësisë të mbahet e mbyllur në qoftë se i akuzuari pranon të jetë dëshmitar bashkëpunues. Pala e dëmtuar nuk mund të merr pjesë në seancë të mbyllur bazuar në këtë paragraf.

(12) Gjatë shqyrtimit se a duhet pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë gjykata duhet ta dëgjoj personalisht të akuzuarin, mbrojtësin e tij/saj dhe prokurorin publik dhe të përcaktojë nëse:

- a) I akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë;
- b) Pranimi i fajësisë është bërë me vullnetin e të akuzuarit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, nëse i akuzuari ka mbrojtës dhe se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar me forcë që të deklarojë fajësinë ose i shtrënguar në çfarëdo mënyre tjetër;
- c) Pranimi i fajësisë mbështetet në fakte të rastit të cilat i përmban aktakuza, materiale të prezantuara nga prokuroria që plotësojnë aktakuzën të cilat janë pranuar nga i akuzuari; dhe në çfarëdo prove tjetër siç mund të jenë deklaratat e dëshmitarëve të prezantuara nga prokurori ose i akuzuari; dhe
- d) Nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara me nenin 316, par. 1-3 të këtij ligji.

(13) Me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë gjykata duhet të dëgjojë pikëpamjet e prokurorit, mbrojtësit dhe palës së dëmtuar. Nëse marrëveshja për bashkëpunimin dhe pranimin e fajësisë e të akuzuarit është e mbyllur në pajtim me paragrafin 11, gjykata do të lejojë palës së dëmtuar të jep deklaratën në përfundim të bashkëpunimit të akuzuarit, para shqiptimit të dënimit.

(14) Nëse gjykata nuk është e bindur se të gjitha kushtet e parapara me paragrafin 12 të këtij neni janë përmbushur, gjykata do ta refuzoj pranimin e fajësisë dhe rasti do të vazhdoj në gjykim ashtu siç parashihet me këtë ligj.

(15) Nëse gjykata është e bindur se të gjitha kushtet e parapara me paragrafin 12 të këtij neni janë përmbushur, gjykata do ta pranoj marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe të urdhëroj që marrëveshja të vendoset në shkresat e lëndës në gjykatë. Gjykata do të caktojë një datë kur palët do të japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin pas së cilës gjykata do të shqiptojë dënimin. Megjithatë, kjo datë mund të shtyhet në mënyrë që i akuzuari të shërbejë si dëshmitar bashkëpunues.

(16) Pasi që gjykata të ketë pranuar pranimin e fajësisë dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në formë të shkruar, por para se të shqiptohet dënimi,

gjykata nuk mund ta lejoj të akuzuarin ta tërheq pranimin e fajësisë ose prokurorin të anulojë marrëveshjen mbi fajësinë përveç nëse gjykata gjen se ndonjë nga kushtet e parapara në paragrafin 12 nuk përmbushet më tej. Pala e cila kërkon të tërhiqet nga marrëveshja e ka barrën e të provuarit gjatë parashtrimit të asaj kërkesë në gjykatë.

(17) Në rast se dispozitat e këtij neni janë në kundërshtim me dispozitat tjera të këtij kodi ose Kodit Penal të Kosovës, këto dispozita kanë përparësi.

Amendamentet tjera në lidhshmëri:

Neni 62.7 (dispozitë e re)

Të drejtat e palës së dëmtuar të kërkojë kthimin e pronës apo kompensimin nga i akuzuari i cili hyn në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me prokurorin nuk do të paragjykohe në asnjë mënyrë si rezultat i pranimin të akuzuarit të hyjë në marrëveshje.

Neni 73.1.5 (dispozitë e re)

Për të gjitha rastet ku i akuzuari kërkon të pranojë fajësinë për vepër penale që mund të dënohet më një ose më tepër vite burgim, i akuzuari duhet të jetë i përfaqësuar nga mbrojtësi, përveç në rastet kur gjykata lejon që procedura të vazhdojë pa përfaqësim të tillë.

Neni 301.3 (dispozitë e re)

Pas kërkesës së prokurorit, gjykata mund ta revokojë urdhrin me të cilin autorizon të akuzuarin të jetë dëshmitar bashkëpunues në pajtim me nenet 298 – 300, në bazë të marrëveshjes mbi fajësinë, nëse i akuzuari ka bërë shkelje materiale të marrëveshjes.

Neni 379.1

Në rastet kur i akuzuari i cili është dëshmitar bashkëpunues pranon fajësinë në bazë të marrëveshjes mbi fajësinë, prokurori mund të rekomandojë gjykatës kufijtë e dënimit, qortimin gjyqësor ose njërën nga dënimet alternative të parashikuara në nenin 41 të Kodit Penal të Kosovës.

## **II. Draft Shtojcë e Nenit 66 të Ligjit Penal mbi Zbutjen e Dënimeve**

(3) Kur kryesi të ketë pranuar fajësinë në përputhje me kushtet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të pranuar nga gjykata bazuar në nenin \_\_\_, dhe marrëveshja mbi pranimin e fajësisë në formë të shkruar përmban një pikë me të cilën mandaton zbutjen e dënimit, gjykata do të shqiptojë një dënim më të butë. Në rast të tillë, gjykata duhet të merr parasysh vështirimet e prokurorit, mbrojtësit, të pandehurit dhe palës së dëmtuar sa i përket zbutjes së dënimit, dhe do të udhëzohet por jo detyrohet nga kufizimet e dhëna me nenin 67.